



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO



GJYKATA THEMELORE PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRISTINA - BASIC COURT PRISHTINA

PS.nr.2/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE-DEPARTAMENTI SPECIAL NË PRISHTINË, me Trupin Gjykes në përbërje nga Gjyqtari Valon Kurtaj-Kryetari i Trupit Gjykes dhe Gjyqtarët Suzana Çerkini e Musa Konxheli-Anëtarë të Trupit Gjykes, me pjesëmarrjen e Bashkëpunëtores Profesionale Ardita Azemi, në çështjen penale kundër të akuzuarve: S.R., I.R., B.M., S.K., F.P., P.M., A.C., A.F., K.S., B.H., H.A., B.B., H.N., S.A., S.N., T.K., F.A., A.M. e B.U. të akuzuar për veprën penale në bashkëkryerje dhe vazhdimësi importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve nga neni 364 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 lidhur me nenin 31 të KPRK, kundër të akuzuarës I.R. e akuzuar për veprën penale falsifikimi i parasë nga neni 296 paragrafi 2 të KPRK si dhe kundër të akuzuarit S.K. i akuzuar për veprën penale mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK, të akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Aktakuzë nën numrin PPS.nr.41/2019 e datës 21.01.2022, pas mbajtjes së një sërë shqyrtimesh gjyqësore në këtë çështje penale e në prezencë të Prokurorit të Prokurorisë Speciale, Prokurore Fikrije Fejzullahu, të akuzuarit S.R. me mbrojtësin Avokat A. H., të akuzuarës I.R. me mbrojtësen e saj Avokate D. H., të akuzuarit B.M. me mbrojtësin e tij Avokat A. A., të akuzuarit S. A. me mbrojtësin e tij Avokat H. M., të akuzuarit S.K. me mbrojtësin e tij Avokat A. D., të akuzuarit A.F. me mbrojtësin e tij Avokat D. K., të akuzuarit A.C. me mbrojtësin e tij Avokat A. M., të akuzuarit K.S. me mbrojtësen e tij Avokat M. B., të akuzuarit B.H. me mbrojtësin e tij Avokat A. T., të akuzuarit P.M. me mbrojtësin e tij Avokat T. I., të akuzuarit F.P. me mbrojtësin e tij Avokat O. H., të akuzuarit F.A. me mbrojtësin e tij Avokat J. I., të akuzuari S.N. me mbrojtësen e tij Avokat F. H., të akuzuarit T.K. me mbrojtësin e tij Avokat B. M., të akuzuarit B.B. me mbrojtësin e tij Avokat Sh. Z., të akuzuarit H.N. me mbrojtësen e tij Avokat L. D. P., të akuzuarit H. N. me mbrojtësen e tij Avokat T. Zh., të akuzuarit A.M.

me mbrojtësin e tij Avokat S. S., të akuzuarit B.U. me mbrojtësin e tij Avokat L. H., të akuzuarit S.K. me mbrojtësen e tij Avokat L. K. G., me datë 26.07.2023, publikisht mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuarve:

- 1. S.R.**, nga i ati U., e ëma I. e vajzërisë D., i lindur me ... në fshatin ... të Komunës së I., me vendbanim në rrugën ... në fshatin ... të Komunës së I., i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të përfunduar shkollimin e mesëm, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, posedon dokument identifikimi me numër personal ..., pa të dhëna se më parë ka qenë i gjykuar për ndonjë vepër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.
- 2. I.R.**, nga i ati D., e ëma H. e vajzërisë D., e lindur me ..., në ... të Malit të Zi, me vendbanim në rrugën ... në fshati ... të Komunës së I., e ve, nënë e pesë fëmijëve, ka të përfunduara katër klasë të shkollimit fillore, amvise, e gjendjes së dobët ekonomike, posedon dokument identifikimi me numër personal ..., pa të dhëna se më parë ka qenë e gjykuar për ndonjë vepër penale, boshnjake, shtetase e Republikës së Kosovës.
- 3. B.M.**, nga i ati T., e ëma S. e vajzërisë M., i lindur me ... në I., me vendbanim rrugën ... në P., i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të përfunduar shkollimin fillor, i gjendjes së dobët ekonomike, posedon dokument identifikimi me numër personal ..., pa të dhëna se më parë ka qenë i gjykuar për ndonjë vepër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.
- 4. S.A.**, nga i ati A., e ëma F. e vajzërisë Th., i lindur më ... në fshatin ... të Komunës së L., ku dhe tani banon, i martuar, baba i pesë fëmijëve, ka të përfunduar shkollimin e mesëm, me profesion bujk, i gjendjes së dobët ekonomike, posedon dokument identifikimi me numër personal ..., pa të dhëna se më parë ka qenë i gjykuar për ndonjë vepër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.
- 5. S.K.**, nga i ati B., e ëma Sh. e vajzërisë D., i lindur më ... në I., me vendbanim në rrugën ... në fshatin ... të Komunës I., i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të përfunduar shkollimin e mesëm, me profesion bujk, i gjendjes së dobët ekonomike, posedon dokument identifikimi me numër personal ..., pa të dhëna se më parë ka qenë i gjykuar për ndonjë vepër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

6. **A.F.**, nga i ati M., e ëma M. e vajzërisë K., i lindur më ... në P., me vendbanim në fshatin ... i Komunës së K., i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të përfunduar shkollimin e mesme, punëtor sigurimi, i gjendjes së mesme ekonomike, posedon dokument identifikimi me numër personal ..., pa të dhëna se më parë ka qenë i gjykuar për ndonjë vepër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.
7. **A.C.**, nga i ati Xh., e ëma Sh. e vajzërisë D., i lindur më ... në P., me vendbanim në rrugën ... në P., i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të përfunduar shkollimin e mesëm, i gjendjes së dobët ekonomike, posedon dokument identifikimi me numër personal ..., pa të dhëna se më parë ka qenë i gjykuar për ndonjë vepër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.
8. **K.S.**, nga i ati Q., e ëma N. e vajzërisë H., i lindur më ... në fshatin ... të Komunës së I., ku edhe tani banon, i pamartuar, ka të përfunduar shkollimin e mesme, me profesion tregtar, i gjendjes së dobët ekonomike, posedon kartë identiteti me numër personal ..., pa të dhëna se më parë ka qenë i gjykuar për ndonjë vepër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.
9. **B.H.**, nga i ati V., e ëma S. e vajzërisë H., i lindur më ... në fshatin ... të Komunës së S., me vendbanim në rrugën ... në P., i divorcuar, baba i shtatë fëmijëve, ka të përfunduar shkollimin fillorë, pensionist, i gjendjes së dobët ekonomike, posedon kartë identiteti me numër personal ..., pa të dhëna se më parë ka qenë i gjykuar për ndonjë vepër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.
10. **P.M.**, nga i ati Sh., e ëma Sh. e vajzërisë H., i lindur më ... në P., me vendbanim në rrugën ... në P., i martuar, baba i katër fëmijëve, ka të përfunduar shkollimin e mesëm, i gjendjes së dobët ekonomike, posedon kartë identiteti me numër personal ..., pa të dhëna se më parë ka qenë i gjykuar për ndonjë vepër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.
11. **F. P.**, nga i ati R., e ëma A. e vajzërisë Sh., i lindur më ... në fshatin ... të Komunës së I., me vendbanim në fshatin ... Komunës së P. në rrugën ..., i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të përfunduar shkollimin e mesëm, me profesion këpucëtar, i gjendjes së dobët ekonomike, posedon kartë identiteti me numër personal ..., pa të dhëna se më parë ka qenë i gjykuar për ndonjë vepër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.
12. **F. A.**, nga i ati A., ëma F. e vajzërisë B., i lindur më ... në fshatin ... të Komunës së Gj., ku edhe tani banon, i martuar, baba i tetë fëmijëve, ka të përfunduar shkollimin fillor, i gjendjes së mesme ekonomike, pronar i kompanisë ..., posedon kartë

identiteti me numër personal ..., më parë i pagjykuar për ndonjë vepër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

13. S. N., nga i ati A., ëma H. e vajzërisë A., lindur me ... në fshatin ... të Komunës së P., tani me banim në Gj. në rrugën ..., i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të përfunduar shkollimin e mesëm, me profesion bujk, i gjendjes së dobët ekonomike, posedon kartë identiteti me numër personal ..., më parë i gjykuar për vepër penale të armëmbajtjes pa leje, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

14. T.K., nga i ati I., ëma A. e vajzërisë M., i lindur më ... në Gj., tani me banim në Gj. në rrugën ..., ka të përfunduar shkollimin e mesëm, me profesion tregtar, i gjendjes së dobët ekonomike, posedon dokument identifikimi me numër personal ..., më parë i pagjykuar për ndonjë vepër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

15. B.B., nga i ati A., ëma A. e vajzërisë V., i lindur më ... në F., tani me banim në F., i martuar, baba i pesë fëmijëve, ka të përfunduar shkollimin e mesëm, me profesion bujk, i gjendjes së mesme ekonomike, posedon dokument identifikimi me numër personal ..., më parë i gjykuar për vepër penale të armëmbajtjes pa leje, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

16. H.N., nga i ati F., ëma Xh. e vajzërisë M., i lindur më ... në fshatin ... të Komunës së V., me vendbanim në fshatin ..., i martuar, baba i pesë fëmijëve, ka të përfunduara tri vite të shkollimit fillor, i gjendjes së dobët ekonomike, posedon dokument identifikimi me numër personal ..., më parë i pagjykuar për ndonjë vepër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

17. H.A., nga i ati H., ëma N. e vajzërisë M., i lindur më ... në fshatin ... të Komunës së M., me vendbanim në V. në rrugën ..., i martuar, baba i pesë fëmijëve, ka të përfunduar shkollimin e mesëm, pensionist, i gjendjes së dobët ekonomike, posedon dokument identifikimi me numër personal ..., më pa rë i pagjykuar për ndonjë vepër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

18. A.M., nga i ati Q., ëma E. e vajzërisë C., i lindur më ... në në fshatin ... të Komunës së K., me vendbanim në fshatin ... të Komunës së K. në rrugën ..., i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të përfunduar shkollimin fillor, me profesion bujk, i gjendjes së dobët ekonomike, posedon dokument identifikimi me numër personal ..., më parë i pagjykuar për ndonjë vepër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

19. B.U., nga i ati O., ëma M. e vajzërisë K., i lindur me ... në I., me vendbanim në I. në rrugën ..., i martuar, baba i katër fëmijëve, ka të përfunduar shkollimin fillor, i gjendjes së dobët ekonomike, posedon dokument identifikimi me numër personal ..., më parë i pagjykuar për ndonjë vepër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

20. S.K., nga i ati N., ëma Z. e vajzërisë Ll., i lindur me datë ... në P., me vendbanim në P. në rrugën ..., i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të përfunduar shkollimin e mesëm, me profesion tregtar, i gjendjes së mesme ekonomike, posedon dokument identifikimi me numër personal ..., më parë i pagjykuar për ndonjë vepër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

I.

Të akuzuarit: S.R., I.R., B.M., S.K., F.P., P.M., A.C., A.F., K.S., B.H., H.A., B.B., H.N., S.A., S.N., T.K., F.A., A.M. dhe B.U.:

JANË FAJTOR

Se nga periudha kohore e papërcaktuar e në vazhdimësi e deri me datën 29.09.2020, respektivisht deri me datën 14.04.2021, duke vepruar sipas marrëveshjes paraprake e me qëllim të furnizimit, transportimit, këmbimit, ndërmjetësimit e shitjes së paautorizuar të armëve, kanë transportuar, ndërmjetësuar e shitur armë të llojeve të ndryshme në mënyrë të paautorizuar me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore të kundërligjshme dhe atë mënyrë që:

I pandehuri S.R., pandehura I.R. dhe sipas marrëveshjes me të pandehurin B.M., fillimisht ka siguruar armë të llojeve të ndryshme nga persona të panjohur të cilat armë i ka mbajtur në shtëpinë e nënës së tij (të pandehurës I.R.) në fshatin ... të Komunës së I.;

Të pandehurit: S.K., F.P., P.M., A.C., A.F., K.S., B.H., H.A., B.B., H.N., S.A., S.N., T.K., F.A. e A.M., duke qenë në dijeni që të pandehurit S.R., I.R. e B.M., merren me shitblerjen e armëve dhe të interesuar për blerjen e tyre, kanë komunikuar fillimisht përmes telefonit me ta, duke u dakorduar për llojin e çmimit e armëve dhe të municionit, pastaj janë takuar në vende të ndryshme si restorante, pompa të derivateve, e më së shpeshti në shtëpitë e tyre, kështu që pas përgjimit e vëzhgimit nga ana e personave të autorizuar (zyrtarëve policor) me datën 29.09.2020, janë kontrolluar shtëpitë e objektet përcjellëse të shtëpive të disa prej të pandehurve me ç'rast në shtëpitë e tyre janë gjetur:

- Tek e pandehura I.R., janë gjetur e sekuestruar: 1 (një) këllëf i pistoletës me ngjyrë të zezë; 1 (një) pajisje për pastrim të armës (brushë dhe vaj për pastrim të armës); 1 (një) kartëmonedhë 100 Euro e falsifikuar me numër serik ...; 5 (pesë) pistoleta “Sig ...” e kalibrit 7.65mm me nga 1 (një) karikator; 1 (një) pushkë gjuetie dytuteshe e prodhit rus me numër serik ...;
- Tek i pandehuri S.K., janë gjetur e sekuestruar: 1 (një) pushkë dhjetëshe gjysmë automatike me numër serik ...; 1 (një) pushkë e gjatë me numër serik ... me 6 (gjashtë) fishekë të pushkës karabinë; 6 (gjashtë) fishekë të kalibrit 9x19x7.62; 2 (dy) fishekë të kalibrit 9x17 RWS dhe 1 (një) palë dylbi taktike 52M/100MAT10X;
- Tek i pandehuri A.F., janë gjetur e sekuestruar: 1 (një) revole e tipit “Bereta” 9mm me numër serik ...; 95 (nëntëdhjetë e pesë) fishekë të kalibrit 9x19 dhe dy karikator;
- Tek i pandehuri K.S., janë gjetur e sekuestruar: 71 (shtatëdhjetë e një) fishekë të kalibrave të ndryshëm;
- Tek i pandehuri H.A., janë gjetur e sekuestruar: 1 (një) pushkë gjuetie “Karataj Magnum” me numër serik ...; 109 (njëqind e nëntë) fishekë të kalibrave të ndryshëm dhe një gëzhjojë; 1 (një) pjesë pushke (dorëz e pushkës dhe një bajonetë e pushkës); 1 (një) pistoletë “Zoraki 917-T” me 1 (një) karikator të zbrazur me numër serik ... dhe 1 (një) këllëf të pushkës së gjuetisë;
- Tek i pandehuri B.B. janë gjetur e sekuestruar: një pistoletë me mbishkrim “Sig ...” e kalibrit 12.65mm me numër serik të dëmtuar 0319 me një karikator; 107 (njëqind e shtatë) fishekë me mbishkrimin “S&B” 7.65 BRSU dhe 4 (katër) fishekë me mbishkrimin “MXT” Auto 300-20; 8 (tetë) fishekë të pushkës së gjuetisë me mbishkrim “CHEDITT” 12mm; 1 (një) fishekë me mbishkrim “ELOOHI 36 Itali”; 1 (një) pistoletë me mbishkrim “ZDK” kalibër 7.62 mm me numër serik AB 884 CCCP e vitit 1974 me një karikator; pistoletë me gaz “EKOL Special 99” kalibër 9mm me P.A.K me një karikator; 4 (katër) paketime me nga 60 fishekë me mbishkrimin 7.62 “CMB” 1995; 50 (pesëdhjetë) fishekë gazi; 486 (katërqindë e tetëdhjetë e gjashtë) fishekë me mbishkrim Auto 300; 200 (dyqind) fishekë me mbishkrimin “S&B” 6.35mm; 234 (dyqind e tridhjetë e katër) fishekë me mbishkrimin 7.65mm br. 13 “S&B”;

- Tek i pandehuri S.A., janë gjetur e sekuestruar: 1 (një) revole “TT” e kalibrit 7.62 mm M57 me karikator; 10 (dhjetë) fishekë të kalibrit 7.62 mm; 34 (tridhjetë e katër) fishekë të kalibrit 9 mm; 2 (dy) shishe vaj për pastrim të armës me mbishkrim “Metan Gun Oil” dhe një kuti me mjete për pastrim të armës;
- Tek i pandehuri S.N., janë gjetur e sekuestruar: 1 (një) pushkë karabinë e markës “Cervena Zvezda” prodhuar në ... me numër serik 112374; 1 (një) pistoletë e vjetër e prodhuar mekanikisht pa numër; 1 (një) kuti e metalit për pastrimin e armëve dhe 4 shufra të metalit për pastrimin e armëve;
- Tek i pandehuri F.A., janë gjetur e sekuestruar: një armë gjuetie “Escort Magnum” me numër serik 648442; 1 (një) armë gjueti “Hatsan Escort” me numër serik 6484226 dhe 1 (një) magazine e armës me 2 fishekë të kalibrit 12mm.

Me këto veprime kanë kryer veprën penale në bashkëkryerje e vazhdimësi, importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve nga neni 364 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 lidhur me nenin 31 të KPRK.

II.

E akuzuara I.R.:

ËSHTË FAJTORE

Se nga data e pavërtetuar e deri me datën 29.09.2020, ka pranuar e poseduar para të falsifikuara, ashtu që gjatë kontrollit të shtëpisë së saj në fshatin ... të Komunës së I..., kontroll i bërë nga ana e Policisë së Republikës së Kosovës, i është gjetur e konfiskuar 1 (një) kartëmonedhë prej 100 (njëqind) Euro me numër serik S01753745291 e cila kartëmonedhë pas ekzaminimit nga Laboratori Forenzikës Kriminolistike, ka rezultuar të jetë e falsifikuar.

Me këto veprime ka kryer veprën penale falsifikimi i parasë nga neni 296 paragrafi 2 të KPRK.

III.

I akuzuari S.K.:

ËSHTË FAJTOR

Se nga data e pavërtetuar e deri me datën 14.04.2021 në kundërshtim me Ligjin Nr. 05/L-022 për Armët, ka mbajtur armë paautorizim, ashtu që gjatë kontrollit nga ana e Policisë së Republikës së Kosovës në shtëpinë e tij në P. në rrugën "...", janë gjetur e sekuestruar 1 (një) pushkë gjuetie dy tytëshe me numër serik ... dhe 7 (shtatë) fishekë të kalibrit 12mm.

Me këto veprime ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK.

Andaj gjykata në kuptim të dispozitave të neneve: 2, 4, 6, 7, 8, 9, 10, 17, 20, 21, 22, 31, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 76, 79, 364 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK, nenin 296 paragrafi 2 të KPRK dhe nenin 366 paragrafi 1 të KPRK, të akuzuarve iu shqipton:

DËNIMIN ME BURGIM DHE GJOBË

1. S.R.:

Për veprën penale si nën **I.** të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **3 (tri) vite e 6 (gjashtë) muaj** në të cilin dënim do t'i llogaritet koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 29.09.2020 deri me datë 18.06.2021.

Duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimi me gjobë në lartësi prej **4.000 (katërmijë) Euro**, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se i akuzuari nuk dëshiron apo nuk ka mundësi ta paguaj dënimin me gjobë, gjykata të akuzuarit do ia zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burgim, duke llogaritur **20 (njëzet) Euro** për një ditë burgimi.

2. I.R.

Për veprën penale si nën **I.** të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **2 (dy) vite e 6 (gjashtë) muaj**.

Duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimi me gjobë në lartësi prej **3.000 (tremijë) Euro**, të cilin dënim e akuzuara duhet ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Për veprën penale si nën **II.** të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **1 (një) viti**.

Gjykata në harmoni me nenin 76 të KPPK, të akuzuarës i vërteton-shqipton dënimin unik me burgim:

Për veprat penale si nën **I.** dhe **II.** të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimin unik me burgim në kohëzgjatje prej **3 (tri) vite burgim** e në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 29.09.2020 deri me datë 18.06.2021.

Në rast se e akuzuara nuk dëshiron apo nuk ka mundësi ta paguaj dënimin me gjobë, gjykata të akuzuarës do ia zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burgim, duke llogaritur **20 (njëzet) Euro** për një ditë burgimi.

3. B.M:

Për veprën penale si nën **I.** të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **3 (tri) vite burgim** në të cilin dënim do t'i llogaritet koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 29.09.2020 deri me datë 18.06.2021.

Duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimi me gjobë në lartësi prej **3.000 (tremijë) Euro**, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se i akuzuari nuk dëshiron apo nuk ka mundësi ta paguaj dënimin me gjobë, gjykata të akuzuarit do ia zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burgim, duke llogaritur **20 (njëzet) Euro** për një ditë burgimi.

4. S.A:

Për veprën penale si nën **I.** të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **2 (dy) vite burgim** në të cilin dënim do t'i llogaritet koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 16.04.2021 deri me datën 08.07.2021.

Duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimi me gjobë në lartësi prej **2.500 (dymijepesëqind) Euro**, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se i akuzuari nuk dëshiron apo nuk ka mundësi ta paguaj dënimin me gjobë, gjykata të akuzuarit do ia zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burgim, duke llogaritur **20 (njëzet) Euro** për një ditë burgimi.

5. S.K.

Për veprën penale si nën **I.** të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **3 (tri) vjet burgim**, në të cilin dënim do t'i llogaritet koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 29.09.2020 deri me datë 18.06.2021.

Duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimi me gjobë në lartësi prej **3.500 (tremijepesëqind) Euro**, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se i akuzuari nuk dëshiron apo nuk ka mundësi ta paguaj dënimin me gjobë, gjykata të akuzuarit do ia zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burgim, duke llogaritur **20 (njëzet) Euro** për një ditë burgimi.

6. A.F.

Për veprën penale si nën **I.** të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **14 (katërbëshjetë) muaj burgim** në të cilin dënim do t'i llogaritet koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 01.10.2020 deri me datën 24.11.2020.

Duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimi me gjobë në lartësi prej **1.500 (njëmijepesëqind) Euro**, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se i akuzuari nuk dëshiron apo nuk ka mundësi ta paguaj dënimin me gjobë, gjykata të akuzuarit do ia zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burgim, duke llogaritur **20 (njëzet) Euro**, për një ditë burgimi.

7. A.C.

Për veprën penale si nën **I.** të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **14 (katërbëdhjetë) muaj burgim** në të cilin dënim do t'i llogaritet koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 29.09.2020 deri me datë 08.12.2020.

Duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimi me gjobë në lartësi prej **1.500 (njëmijepesëqind) Euro**, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se i akuzuari nuk dëshiron apo nuk ka mundësi ta paguaj dënimin me gjobë, gjykata të akuzuarit do ia zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burgim, duke llogaritur **20 (njëzet) Euro** për një ditë burgimi.

8. K.S.

Për veprën penale si nën **I.** të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **14 (katërbëdhjetë) muaj burgim** në të cilin dënim do t'i llogaritet koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 29.09.2020 deri me datën 28.12.2020.

Duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimi me gjobë në lartësi prej **1.500 (njëmijepesëqind) Euro**, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se i akuzuari nuk dëshiron apo nuk ka mundësi ta paguaj dënimin me gjobë, gjykata të akuzuarit do ia zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burgim, duke llogaritur **20 (njëzet) Euro** për një ditë burgimi.

9. B.H.

Për veprën penale si nën **I.** të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **14 (katërbëdhjetë) muaj burgim** në të cilin dënim do t'i llogaritet koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 29.09.2020 deri me datën 28.12.2020.

Duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimi me gjobë në lartësi prej **1.500 (njëmijepesëqind) Euro**, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se i akuzuari nuk dëshiron apo nuk ka mundësi ta paguaj dënimin me gjobë, gjykata të akuzuarit do ia zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burgim, duke llogaritur **20 (njëzet) Euro** për një ditë burgimi.

10. P.M.

Për veprën penale si nën **I.** të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **14 (katërbëdhjetë) muaj burgim** në të cilin dënim do t'i llogaritet koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 29.09.2020 deri me datën 28.12.2020.

Duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimi me gjobë në lartësi prej **1.500 (njëmijepesëqind) Euro**, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se i akuzuari nuk dëshiron apo nuk ka mundësi ta paguaj dënimin me gjobë, gjykata të akuzuarit do ia zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burgim, duke llogaritur **20 (njëzet) Euro** për një ditë burgimi.

11. F.P.

Për veprën penale si nën **I.** të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **14 (katërbëdhjetë) muaj burgim** në të cilin dënim do t'i llogaritet koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 29.09.2020 deri me datën 28.12.2020.

Duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimi me gjobë në lartësi prej **1.500 (njëmijepesëqind) Euro**, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se i akuzuari nuk dëshiron apo nuk ka mundësi ta paguaj dënimin me gjobë, gjykata të akuzuarit do ia zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burgim, duke llogaritur **20 (njëzet) Euro** për një ditë burgimi.

12. F.A.

Për veprën penale si nën **I**. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **14 (katërbëdhjetë) muaj burgim** në të cilin dënim do t'i llogaritet koha e kalimit në arrest shtëpiak nga data 16.04.2021 deri me datën 08.07.2021.

Duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimi me gjobë në lartësi prej **1.500 (njëmijepesëqind) Euro**, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se i akuzuari nuk dëshiron apo nuk ka mundësi ta paguaj dënimin me gjobë, gjykata të akuzuarit do ia zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burgim, duke llogaritur **20 (njëzet) Euro** për një ditë burgimi.

13. S.N.

Për veprën penale si nën **I**. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **14 (katërbëdhjetë) muaj burgim** në të cilin dënim do t'i llogaritet koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 16.04.2021 deri me datën 08.07.2021.

Duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimi me gjobë në lartësi prej **1.500 (njëmijepesëqind) Euro**, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se i akuzuari nuk dëshiron apo nuk ka mundësi ta paguaj dënimin me gjobë, gjykata të akuzuarit do ia zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burgim, duke llogaritur **20 (njëzet) Euro** për një ditë burgimi.

14. T.K.

Për veprën penale si nën **I**. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **2 (dy) vite burgim** në të cilin dënim do t'i llogaritet koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 16.04.2021 deri me datën 18.06.2021.

Duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimi me gjobë në lartësi prej **2.500 (dymijepesëqind) Euro**, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se i akuzuari nuk dëshiron apo nuk ka mundësi ta paguaj dënimin me gjobë, gjykata të akuzuarit do ia zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burgim, duke llogaritur **20 (njëzet) Euro** për një ditë burgimi.

15. B.B.

Për veprën penale si nën **I.** të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **2 (dy) vite burgim**.

Duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimi me gjobë në lartësi prej **2.500 (dymijepesëqind) Euro**, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se i akuzuari nuk dëshiron apo nuk ka mundësi ta paguaj dënimin me gjobë, gjykata të akuzuarit do ia zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burgim, duke llogaritur **20 (njëzet) Euro** për një ditë burgimi.

16. H.N.

Për veprën penale si nën **I.** të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **2 (dy) vite burgim** në të cilin dënim do t'i llogaritet koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 16.04.2021 deri me datën 18.06.2021.

Duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimi me gjobë në lartësi prej **2.500 (dymijepesëqind) Euro**, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se i akuzuari nuk dëshiron apo nuk ka mundësi ta paguaj dënimin me gjobë, gjykata të akuzuarit do ia zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burgim, duke llogaritur **20 (njëzet) Euro** për një ditë burgimi.

17. H.A.

Për veprën penale si nën **I.** të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **2 (dy) vite burgim** në të cilin dënim do t'i llogaritet koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 16.04.2021 deri me datën 08.07.2021.

Duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimi me gjobë në lartësi prej **2.500 (dymijepesëqind) Euro**, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se i akuzuari nuk dëshiron apo nuk ka mundësi ta paguaj dënimin me gjobë, gjykata të akuzuarit do ia zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burgim, duke llogaritur **20 (njëzet) Euro** për një ditë burgimi.

18. A.M.

Për veprën penale si nën **I.** të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **14 (katërbëdhjetë) muaj burgim**.

Duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimi me gjobë në lartësi prej **1.500 (njëmijepesëqind) Euro**, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se i akuzuari nuk dëshiron apo nuk ka mundësi ta paguaj dënimin me gjobë, gjykata të akuzuarit do ia zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burgim, duke llogaritur **20 (njëzet) Euro** për një ditë burgimi.

19. B.U.

Për veprën penale si nën **I.** të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **2 (dy) vite e 6 (gjashtë) muaj burgim**, në të cilin dënim do t'i llogaritet koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 29.09.2020 deri me datë 08.12.2020.

Duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimi me gjobë në lartësi prej **3.500 (tremijepesëqind) Euro**, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se i akuzuari nuk dëshiron apo nuk ka mundësi ta paguaj dënimin me gjobë, gjykata të akuzuarit do ia zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burgim, duke llogaritur **20 (njëzet) Euro** për një ditë burgimi.

20. S.K.

Për veprën penale si nën **III.** të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia vërtetuar-shqiptuar dënimi me gjobë në lartësi prej **1.500 (njëmijepesëqind) Euro**, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se i akuzuari nuk dëshiron apo nuk ka mundësi ta paguaj dënimin me gjobë, gjykata të akuzuarit do ia zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burgim, duke llogaritur **20 (njëzet) Euro** për një ditë burgimi.

MARRJA E SENDIT (KONFISKIMI) konfiskohen përgjithmonë sendet-pasuria (provat) si mjete që kanë mundësuar kryerjen e veprës penale, të përdorura e të destinuara për kryerjen e veprës penale dhe sende-pasuri që i nënshtrohet automatikisht konfiskimit, të gjitha të konfiskuara sipas propozimit për konfiskim në aktin akuzues PPS.nr.41/2019 të datës 21.01.2022 dhe atë:

Pasuri-sendet:

- Veturë “VW Golf 1K” me targa 03-460-EO, pronë B.M.;
- Veturë “VW Vento” me targa NP-023-UN, pronë e S. dhe I.R.;
- Para në vlerë prej 2.000 (dymijë) Euro, pronë (mjete të konfiskuara) nga F.P.;

Armët, municioni-provat:

- 1 këllëf i pistoletës ngjyrë e zezë, pajisje për pastrim të armës (brushë dhe vaj);
- Kartëmonedhë prej 100 Euro me numër serik S01753745291;
- 5 pistoleta “Sig Sauer P365” 7.65mm me nga një karikator;
- Pushkë gjuetie dy tytëshe prodhim rus me numër serik 8862627;
- Pushkë dhjetëshe gjysmë automatike me numër serik 474563;
- Pushkë e gjatë me numër serik 223463;
- 6 fishek të pushkës “Karabinë”;
- 6 fishek të kalibrit 9x19 / 7.62;
- 2 fishek të kalibrit 9x17 RWS;
- Dylbi taktike;
- 1 pistoletë e tipit “Bereta” 9 mm;
- 95 fishekë të kalibrit 9x19 dhe dy karikator;
- 71 fishekë të kalibrave të ndryshëm;
- 1 pushkë “Bjuefie Karatay Magnum” me numër serik 15882,
- 109 fishekë të kalibrave të ndryshëm dhe një gëzhjojë;
- Pjesë pushke (1 dorëza dhe 1 bajonetë);
- 1 pistoletë “Zoraki 9174” me një karikator të zbrazur me numër serik 121800366;
- 1 këllëf i pushkës së gjuetisë;

- 1 pistoletë me mbishkrimin “Sig Sauer” P365 e kalibrit 12.65mm me numër serik të dëmtuar 0319 me një karikator;
- 107 fishekë me mbishkrim 165 BR (SU CLHE);
- 4 fishekë me mbishkrim “MXI Auto 300/20”;
- 8 fishekë të pushkës së gjuetisë me mbishkrim “CHF/DITT 12 mm-F”;
- 1 fishekë me mbishkrim “ELOOHI 36” prodhim Italian;
- 1 pistoletë me mbishkrim “ZDK” e kalibrit 7.62mm me numër serik AB 884 CCCP 1974 me një karikator;
- 1 pistoletë me gaz “EKOL Special 99” kalibrit 9 mm (P.A-K) me një karikator;
- 4 paketime me nga 60 fishekë me mbishkrimin 7.62CMB 1995;
- 50 fishekë gazi;
- 486 fishekë me mbishkrim “Auto 300”;
- 200 fishekë me mbishkrimin “S&B” 6.35 mm;
- 234 fishekë me mbishkrimin “7.65 Br13S&B”
- 1 revole “TT” e kalibrit 7.62mm M57 me karikator;
- 10 fishekë të kalibrit 7.62mm,
- 34 fishekë të kalibrit 9m.m;
- 2 shishe vaj për pastrim të armës me mbishkrim “Metan Gun Oil” dhe një kuti me mjete për pastrim të armës;
- 1 pushkë karabinë e markës “Crvena Zvezda” e prodhimit të Kragujevcit me numër serik 112374;
- 1 pistoletë e vjetër e prodhuar mekanikisht (artizanale) pa numër;
- 1 kuti e metalit për pastrimin e armëve dhe 4 shufra të metalit për pastrimin e armëve;
- 1 armë gjuetie “Eskort Magnum” me numër 648442;
- 1 armë gjuetie “Hatsan Escort” me numër 6484226;
- 1 magazinë e armës me 2 fishekë 12mm.

Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi në harmoni me nenin 276 paragrafi 2 pika 2.1 dhe paragrafi 4 të KPPRK, urdhërohet shkatërrimi i armëve të konfiskuara të përdorura në kryerjen e veprës penale (meqë janë pasuri që i nënshtrohet automatikisht konfiskimit).

Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, obligohet Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Konfiskuar të marrë nën administrimin e saj pasurinë e konfiskuar sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe të njëjtën ta administrojë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Obligohen të akuzuarit-çdo njëri prej tyre (veç e veç) të paguaj shumën prej **100 (njëqind) Euro** në emër të shpenzimeve procedurale dhe shumën prej **100 (njëqind) Euro** në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Historiku procedural i çështjes:

Më 21.01.2022, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, ka ngritur Aktakuzën PPS.nr.41/2022, kundër të akuzuarve: S.R., I.R., B.M., S.K., F.P., P.M., A.C., A.F., K.S., B.H., H.A., B.B., H.N., S.A., S.N., T.K., F.A., A.M. dhe B.U., që të gjithë të akuzuar për veprën penale importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve nga neni 364 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 lidhur me nenin 31 të KPRK; ndërsa e akuzuara I.R., për veprën penale falsifikimi i parasë nga neni 296 paragrafi 2 të KPRK dhe i akuzuari S.K., për veprën penale mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK.

Me datë 02.05.2022, Gjykata Themelore-Departamenti Speciale në Prishtinë, ka mbajtur shqyrtimin fillestar në këtë çështje penale, ku të akuzuarit kanë kundërshtuar aktin akuzues dhe sa i përket fajësisë, kanë deklaruar se nuk e pranojnë fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohen, andaj të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre, janë njoftuar se në afat të caktuar ligjor, kanë mundësinë për të parashtruar kërkesat për hedhjen e aktit akuzues dhe kundërshtimet ndaj provave.

Pas parashtrimit të kërkesave për hedhjen e aktit akuzues dhe kundërshtimet ndaj provave nga të akuzuarit-mbrojtësit e tyre, gjykata të njëjtat i ka shqyrtuar e më pas i ka hedhur si të pabazuara.

Të akuzuarit-mbrojtësit e tyre në afat ligjor kanë ushtruar ankesë ndaj vendimit me të cilin janë hedhur kërkesat për hedhjen e aktit akuzues dhe kundërshtimet ndaj provave. Gjykata Apelit-Departamenti Special në Prishtinë, në raport me ankesat e ushtruara, ka refuzuar të njëjtat dhe vendimin e shkallës së parë e ka lënë në fuqi.

Gjykata, në drejtim të procedimit të këtij akti akuzues dhe kësaj çështje penale, ka mbajtur një sërë shqyrtimesh gjyqësore, ku me datë 26.07.2023, ka bërë shpalljen e këtij aktgjykimi.

Fjala përfundimtare e palëve:

Palët në këtë çështje penale kanë parashtruar me shkrim fjalën përfundimtare, ku gjykata në këtë pjesë do të shtjelloj-potencoj pretendimet e theksuara në fjalën përfundimtare.

Prokuroria Speciale Republikës Kosovës, respektivisht Prokurorja Speciale në fjalën e saj përfundimtare ka theksuar:

- Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, Prokuroria konsideron se veprat penale të përshkruara në aktakuzë janë vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të qartë. Nga raportet e masave të fshehta të përgjimit e të vëzhgimit, pa mëdyshje vërtetohet se të pandehurit kanë komunikuar, kanë kontaktuar mes veti e janë takuar në vende të ndryshme me qëllim të gjetjes së blerësve, ndërmjetësuesve dhe shitësve të armëve. Kjo e bën të qëndrueshëm faktin që veprimtaria e përshkruar në aktakuzë është ndërmarrë në formë të marrëveshjeve paraprake dhe se secili nga të akuzuarit ka kryer veprime në mënyrë të përshkruar në aktakuzë me dashje e paramendim, tërë kjo me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore në mënyrë të kundërligjshme.
- Nga raporti i ekzaminimit të pajisjeve elektronike-telefonave të të akuzuarve i datës 13.01.2021, rezulton që në telefonin e të akuzuarit B.M., “Iphone-6” gjenden SMS në “Facebook” messenger dhe në “WhatsApp” fotografi të armëve. Në telefonin e të akuzuarës I.R., “Samsung Note 3” gjenden dy foto të armëve-revole të ndryshme dhe në telefonin e të akuzuarit P.M., shihet një foto me armë në dorë. Në telefonin e të akuzuarit A.C., shihet një revole dhe një foto ku i njëjti mban në dorë një “AK-47”.
- Nga përmbajtja e mesazheve përmes “WhatsApp”, rezulton që i akuzuari B.M., komunikon me persona të ndryshëm ku qartë shihet se flitet për kërkesa për shitblerje të armëve (“a ki kun njo aso me 9 mm, jo fishekë komplet e re me dy karikator me kuti të re etj.”), ku nga përmbajtja e mesazheve përmes “WhatsApp” rezulton që i akuzuari A.F., komunikon me të akuzuarin B.M., lidhur me armë e municion (“mos ki karikator të kallashit, made in Kina, 9she ruse, 400 ja marrim me mujt me shit 500 etj.”). Gjithashtu edhe foto të armëve të ndryshme gjenden në telefonat e tyre gjë që vërteton faktin që të akuzuarit i kanë fotografuar armët për tu dakorduar rreth çmimit dhe llojit të tyre.
- Nga raporti i përgjimeve dhe vëzhgimeve rezulton që të akuzuarit kanë biseduar mes veti, janë marrë vesh për vendin e kohën e takimeve, janë takuar mes veti dhe kështu kanë shkëmbyer armët dhe paratë. Nga raporti i vëzhgimit qartë shihen kur të akuzuarit S.N., H.N. e T.K., shkojnë tek shtëpia e të akuzuarit F.A. dhe fotot ku e provojnë një armë. Gjithashtu deklaratat e të pandehurve në prokurori e disa prej tyre edhe në gjykatë, janë kontradiktore e në shpërputhje të plotë me provat materiale e dëshmitë e dëshmitarëve, ku në veprimet e tyre në plotësishtë përmbushen elementet e veprave penale të përshkruara në aktakuzë, ndërkaq përtej

çdo dyshimi është vërtetuar se qëllimi i tyre ka qenë përfitimi i dobisë pasurore në mënyrë të kundërligjshme. Lidhmëria logjike e provave të drejtpërdrejta, por edhe atyre rrethore nuk lë asnjë dyshim se të akuzuarit kanë vepruar me dashje dhe me vetëdije të plotë, andaj gjykatës i ka propozuar që të njëjtit t'i shpallë fajtor dhe t'i dënoj sipas ligjit. Gjykata në këtë rast të merr parasysh shkallën e rrezikshmërisë së veprave penale e pasojat e shkaktuara, sasia e madhe e armëve e bënë edhe më të theksueshëm faktin që rrezikshmëria shoqërore është e madhe, kjo për shkak se një numër i madh i veprave penale që kryhen në vendin tonë, pikërisht mjet përdorimi kanë armët, po ashtu i ka propozuar gjykatës që të bëhet konfiskimi i sendeve të propozuara me aktakuzë.

I akuzuari **S.R.**, respektivisht mbrojtësi i tij Avokat A. H., në fjalën përfundimtare ka theksuar:

- Pas shumë seancave gjyqësore prokuroria nuk ka arrit të vërtetojë përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari S.R., ta ketë kryer veprën penale që i vihet në barrë, kjo ngase prokuroria nuk ka sjellë asnjë provë të mjaftueshme për të vërtetuar një gjë të tillë, përkatësisht me ato prova që janë administruar në shqyrtim gjyqësor nuk është dëshmuar se i mbrojturi i tij të ketë kryer veprën penale, si dhe nuk kalohet pragu i standardit të kriterit të provuarit në gjykatat tona. Aktakuza si e tillë me gabime faktike dhe shkelje të qarta ligjore nuk ka se si të akceptohet e të vërtetohet se është kryer vepra penale nga i mbrojturi i tij, kjo ngase prokuroria në fjalën hyrëse ka deklaruar se të akuzuarit të gjithë nuk njihen në mes vete andaj shtrohet pyetja se si mund të vërtetohet elementi i bashkëkryerjes në kontekst të cilësimit juridik të veprës penale.
- Në këtë çështje nuk janë dëgjuar dëshmitarë, përkatësisht nuk janë administruar prova personale, pra askush nuk ka dëshmuar në dëm të të mbrojturit të tij dhe se tek i mbrojturi i tij ka theksuar nuk është sekuestruar armë apo ndonjë gjë e ndaluar me ligj. Gjithashtu nga provat materiale të cilat janë administruar nuk është dëshmuar absolutisht asgjë, lidhur me “SMS” dhe fotografitë e nxjerra nga pajisjet e të akuzuarve nuk dëshmohet asgjë, ngase nga pajisjet e të mbrojturit të tij nuk ka rezultuar kurrfarë “SMS” as fotografi, po ashtu lidhur me raportet e përgjimeve të bisedave telefonike edhe “SMS” gjithashtu nuk kanë fuqi provuese, pasi që nuk vërtetohet gjendja faktike e përshkruar në aktakuzë, andaj nga thëniet e mësipërme dhe elaborimi i rrjedhës së procedurës me provat e administruara, ka theksuar se rezulton se i mbrojturi i tij është i pafajshëm, ku ka kërkuar nga gjykata që të nxjerr aktgjykim lirues.

E akuzuara **I.R.**, respektivisht mbrojtësja e saj Avokate D. H., në fjalën përfundimtare ka theksuar:

- Pas shumë seancave gjyqësore prokuroria nuk ka arritur të vërtetojë përtej dyshimit të bazuar mirë se e akuzuara I. R., ta ketë kryer veprën penale që i vihet në barrë, kjo ngase prokuroria nuk ka sjellë asnjë provë të mjaftueshme për të vërtetuar një gjë të tillë, përkatësisht me ato prova që janë administruar në shqyrtim gjyqësor nuk është dëshmuar se e mbrojtura e saj të ketë kryer veprën penale. Nuk kalohet pragu i standardit të kriterit të provuarit në gjykatat tona. Aktakuza si e tillë me gabime faktike dhe shkelje të qarta ligjore nuk ka se si të akceptohet dhe të vërtetohet se është kryer vepra penale si në pikën I. të aktakuzës nga e mbrojtura e saj, kjo ngase prokuroria në fjalën hyrëse ka deklaruar se të akuzuarit të gjithë nuk njihen në mes vete andaj shtrohet pyetja se si mund të vërtetohet elementi i bashkëkryerjes në kontekst të cilësimit juridik të veprës penale.
- Lidhur me veprën penale si në pikën II. të dispozitivit të aktakuzës, nuk është vërtetuar se e mbrojtura e saj të ketë ditur se paraja është e falsifikuar ku neni 296 i KPRK e përcakton qartë se elementi crucial te kjo vepër penale është që kryesi të ketë ditur që paratë janë të falsifikuara, kurse në shqyrtimin gjyqësor nuk është administruar asnjë provë personale apo materiale për të dëshmuar elementin në fjalë, pra dijeninë e të mbrojturës së saj që këto të holla qenkan të falsifikuara. Në këtë çështje penale nuk janë dëgjuar dëshmitarë dhe nuk janë administruar prova personale, pra askush nuk ka dëshmuar në dëm të të mbrojturës së saj, po ashtu provat materiale nuk janë elaboruar e as komentuar specifikisht në seancë gjyqësore. Andaj, konsideron se provat janë të pamjaftueshme për të dëshmuar përtej dyshimit të bazuar mirë se e mbrojtura e saj të ketë kryer veprat penale në fjalë, ku nga thëniet e mësipërme dhe elaborimi i rrjedhës së procedurës me provat e administruara, ka theksuar se rezulton se e mbrojtura e saj është e pafajshëm dhe ka kërkuar nga gjykata që të nxjerr aktgjykim lirues.

I akuzuari **B.M.**, respektivisht mbrojtësi i tij Avokat A. A., në fjalën përfundimtare ka theksuar:

- Prokuroria gjatë dyshimeve fillestare ishte nisur me bindjen se kemi të bëjmë këtu me një vepër penale të kimit të organizuar edhe pse mbrojtësit e kishin kundërshtuar këtë aspekt që në fillim, duke u bazuar në faktet të cilat ishin në dispozicion nga “hetimet intensive” të hetuesve nga Departamenti i krimeve të rënda. Mbrojtja ishte e mendimit edhe atëherë se nuk kishte elemente për atë vepër penale por që kjo u dëshmuar më vonë se nuk ishte reale dhe se nuk plotësoheshin kushtet për një cilësim të tillë. Pyetja në vazhdim ka të bëjë me

aspektet tjera të kualifikimit juridik të çështjes sipas dispozitave nga neni 364 paragrafi 2 e lidhur me nenin 31 të KPRK, sepse mbrojtja nuk është e mendimit se qëndron edhe ky kualifikim, duke pasur parasysh faktet e hetuara si dhe provat e prezantuara nga prokuroria kompetente. Mbrojtja është e mendimit se i gjithë hetimi i kësaj çështje lëngon esencialisht nga të metat themelore në lidhje me kualifikimin ligjor të kësaj vepre. Thënë ndryshe, si është e mundur që dikush të akuzohet për një vepër kaq të rënd duke mos pasur asnjë provë relevante në lidhje me veprën e dyshuar.

- Mbrojtja me keqardhje konstaton se prokuroria kompetente ka dështuar që të argumentoj se i mbrojturi i tij ka kryer veprën penale importit, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, ndërmjetësimi ose shitja e armëve e paraparë me dispozitat e nenit 364 paragrafi 2 e lidhur me nenin 31 të KPRK, që paraqet veprimet e bashkëkryerjes si formë e kualifikuar e veprës bazë. Organi i ndjekjes penale me asnjë fakt dhe me asnjë provë ose dëshmi konkrete nuk kishte arritur që të vërtetoj tezën e akuzës së saj në lidhje me veprimet konkrete të të mbrojturit B.M. dhe rrjedhimisht nuk qëndron fakti se i njëjti e ka kryer këtë vepër e cila i ngarkohet. Të gjitha elementet juridike të kësaj vepre penale të dyshuar do të duhej që të qartësoheshin deri në masën e cila kësaj akuze do t'i jepte kredibilitet dhe besueshmëri, sepse kështu sikur që është provuar që të argumentohet ligjërisht është e pamjaftueshme.
- Mbrojtja nuk e ka kuptuar fare se në cilën kohë, cilën periudhë kohore, me cilat veprime konkrete dhe të dëshmuara i mbrojturi ka mundur që të kryej veprën e cila atij i është vënë në barrë. Për më tepër, organi i ndjekjes penale nuk ka arsyetuar veprimet e të mbrojturit tonë duke u bazuar në dispozitat e nenit 31 të KPRK, që flasin për bashkëkryerjen të cilën prokuroria ia ka mveshur të mbrojturit të tij si dhe të tjerëve kur në fakt edhe gjatë gjykimit nuk janë vërtetuar supozimet e ndjekjes penale se këta persona kanë vepruar në bashkëkryerje. Mbrojtja e konteston faktin e tillë të mveshur, sepse shumica absolute e personave në këtë akuzë nuk njihen fare mes vehte dhe as që kanë komunikuar mes vehte, qoftë përmes telefonit, qoftë përmes komunikimit fizik apo përmes rrjeteve sociale ose në ndonjë mënyrë tjetër të komunikimit.
- Mbrojtja konstaton se të gjitha veprat penale të cilat mund të kryhen në bashkëkryerje, element të përbashkët e kanë veprimin konkret me personat tjerë me të cilët njihen mirë dhe ata i bashkërendojnë veprimet e tyre me dashje dhe kontribuojnë thelbësisht me veprimet e tyre në kryerjen e veprës së dyshuar. Dëshirojmë të themi se në rastin konkret B.M., nuk kishte ndërmarrë aktin konkret të kryerjes së veprës sikur në aktakuzën e prokurorisë dhe nëse këtij mund t'i

mveshet një dyshim për aktivitetet joligjore deri te e cila ka ardhur ndjekja penale duke u bazuar në disa përgjime telefonike të bisedave ose qoftë përmes disa komunikimeve përmes rrjeteve të hapura sociale, atëherë vetëm ky fakt është i pamjaftueshëm për të akuzuar dike se ka kryer vepër të caktuar. Në çdo rast organi i ndjekjes penale ka mbetur borgj që të na arsyetoj se cilat ishin rezultatet e këtyre bisedave telefonike, cilat ishin ato biseda që ishin realizuar konkretisht dhe çka ka rezultuar nga ato biseda telefonike. Nëse rrjedh se atij i janë faktuar veprimet nga akuza e që kanë të bëjnë me veprën sikur në aktin akuzues, kjo do të ishte një kualitet dhe provë, mirëpo në rastin konkret atij nuk i janë dëshmuar asnjë provë konkrete se pas ndonjërës bisedë ka rezultuar një veprim konkret ose se të njëjtit i është gjetur ndonjëri nga sendet e biseduara nga përgjimet në mënyrë që të themi se ky është rezultati i këtyre bisedave dhe ky është veprimi konkret.

- Mbrojtja ka konstatuar se vetëm disa biseda të papërshtatshme telefonike ose dërgimi i SMS përmes rrjetit social të caktuar, nuk përbën vepër penale dhe aq më pak kur nuk rezulton nga të gjitha ato biseda se është realizuar ndonjë veprim konkret ose është prodhuar ndonjë efekt konkret nga bisedat. Mbrojtja konsideron se organi i akuzës ka dështuar që të zhvilloj hetimet deri në fund dhe me themel për të nxjerrë përfundime relevante për akuzën e saj dhe si duket nga këto hetime sipërfaqësore janë nxjerrë edhe përfundime të gabuara në lidhje me shumicën e personave që këtu janë akuzuar, fatkeqësisht edhe në lidhje me të mbrojturin tonë B.M., i cili pa të drejt është akuzuar dhe të njëjtit i janë kufizuar të drejtat themelore dhe individuale në këtë procedurë me vet faktin se mbi tre vite është duke u hetuar për disa biseda irelevante dhe që në fund të kësaj procedure kanë mbetur të pa faktuara.
- Mbrojtja e B.M., ka konstatuar se kanë ekzistuar disa dyshime të bazuara se i njëjti ka lëvizur në kufirin e ligjit sepse ato biseda sado që kanë qenë të papërshtatshme dhe të dyshimta, ato nuk kanë treguar se janë realizuar praktikisht. Mbrojtja është e mendimit se i gjithë hetimi do të duhej që të dëshmonte së paku një provë, një dëshmi, një fakt konkret se i njëjti ka realizuar qoftë një posedim të paligjshëm të armës konkrete, qoftë realizimin e ndonjërës kategori nga dispozita e nenit 364 paragrafi 2 të KPRK, ose që të njëjtit të mundet që t'i mveshet veprimi konkret i "importit", "eksportit", "furnizimit", "këmbimit", "ndërmjetësimit" ose "shitjes".
- Mbrojtja e kupton ndjeshmërinë e këtyre rasteve por nuk është detyrë e mbrojtjes që të siguroj provat ose dëshmitë për organet tjera, por që të kërkoj nga ato që të ofrojnë këto prova dhe dëshmi për një proces të rregullt e të drejt e ligjor. Për fat të keq kjo nuk ka ndodhur për sa i përket B.M., duke pasur parasysh se organi i

ndjekjes penale nuk ka arritur që të siguroj asnjë dëshmi (përveç disa biseda telefonike të pa precizuara), asnjë provë fizike (nuk ka gjetur asnjë lloj arme në banesën e tij ose në automjetin të cilin e ka përdorur ky), nuk ka siguruar asnjë moment të shitjes ose blerjes (nuk e ka faktuar asnjë rast), nuk e ka dëshmuar se i njëjti ndonjëherë më parë është marrë me veprime konkrete të kësaj natyre, nuk ka siguruar asnjë deklaratë fajësuese qoftë nga një i vetëm dëshmitarë, nuk ka realizuar asnjë lloj rasti të simulimit i cili do të faktonte një veprim konkret të tij në drejtim të veprës në fjalë. Po ashtu nuk ka siguruar asnjë provë të natyrës tjetër ose qoftë forenzike, nuk ka siguruar në këtë rast e si do të mundet që mbrojtja të pranoj një akuzë të tillë të pa mbuluar me asnjë provë dhe asnjë dëshmi konkrete.

- Mbrojtja në fillim ka qenë edhe vet e rezervuar, sepse nuk i ka ditur të gjitha provat dhe faktet relevante, mirëpo a mund të pranoj një situatë të tillë faktike si çështje e kryer dhe duke u bazuar vetëm në biseda të lira përmes telefonit ose rrjeteve të hapura sociale, të mundet dikush që të akuzohet dhe të shpallet fajtor për një vepër kaq të rëndë. Mbrojtja është e mendimit se kjo mënyrë dhe kjo praktikë nuk duhet që të lejohet të kaloj sepse në këtë mënyrë rrezikohen vlerat esenciale që kanë të bëjnë me të drejtat dhe liritë themelore e individuale e të njeriut dhe se në këtë mënyrë rrezikohet që të instalohet një praktikë e cila rrezikon esencialisht sistemin juridik-penal në Republikën e Kosovës, i cili sistem është i mbrojtur nga ligjdhënësi fuqishëm si dhe nga Kushtetuta e vendit. Mbrojtja është e mendimit se gjithmonë ekziston përparësia e interpretimit ligjor dhe i së drejtës në favor të palës së pandehur sa herë që ekzistojnë dyshimet por që ato dyshime nuk janë fuqizuar deri në atë masë sa pa asnjë dyshim është provuar me fakte dhe dëshmi plotësuese dyshimi fillestar. Rasti konkret i B.M., nuk është fuqizuar me asnjë provë dhe dëshmi shtesë (përveç dyshimeve fillestare) se i njëjti ka kryer veprën e cila atij i është vënë në barrë.

I akuzuari **S.A.**, respektivisht mbrojtësi i tij Avokat A. J. në fjalën përfundimtare ka theksuar:

- Nëse e analizojmë fjalën përfundimtare të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, vijmë në përfundim se nuk janë dhëne sqarimet e nevojshme për veprimet inkriminuese të të pandehurve dhe se cilat janë provat mbështetëse për këto pretendime, çdo herë me theks në raport me të mbrojturin e tij nuk është sqaruar se cilat janë veprimet konkrete të cilat nënkuptojnë bashkëpunimin me të pandehurit e tjetër me të cilët do të konsumohej figura e veprës penale e cila i është vënë në barrë. Në raport me të mbrojturin e tij është gjetur një armë e cila nga konsultimi me të njëjtin kam kuptuar se ka qenë e vajzës së tij mirëpo edhe në situatën sikurse arma të ishte e tij, kjo nënkupton veprim inkriminues me të cilën

plotësohet figura e një vepre tjetër penale. Prandaj në mungesë të provave materiale dhe personale i ka propozuar gjykatës që ndaj të mbrojturit të tij të nxjerr aktgjykim lirues.

I akuzuari **S.K.**, respektivisht mbrojtësi i tij Avokat A. D. në fjalën përfundimtare ka theksuar:

- Aktakuza e ngritur nga ana e përfaqësuesit të saj është paushalle dhe e paargumentuar me provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës për faktin se nuk janë kontestuese rrethanat se me rastin e bastisjes në shtëpinë e të pandehurit S.K., janë gjetur dy armë dhe atë një pushkë dhjetëshe gjysmë automatike dhe një pushkë e gjatë, 6 predha të pushkës karabine, 6 predha të kalibrit 7.62 mm, 2 fishekë 9x17, një palë dylbi, ku me këtë rast është sekuestruar edhe telefoni i të pandehurit i markës “Samsung”, ku në mbrojtjen e tij i pandehuri ka theksuar se njëra nga këto pushkë i ka ngelur që nga koha e luftës në Kosovë. Armë të cilën nuk e ka dorëzuar meqë i njëjti ka fermë të bagëtive (lopëve) dhe me to që nga muaji Qershor gjer në fillim të muajit Tetor i dërgon në bjeshkën e I. dhe të njëjtën e ka mbajtur për çështje sigurie, ndërsa pushkën tjetër e cila iu është konfiskuar është pushkë për të cilën mund të sigurohet leja përkatëse, për çka për sigurimin e kësaj leje iu është drejtuar Qendrës së trajnimit për armët.
- Sipas aktakuzës, i akuzuari S.K. akuzohet se në bashkëkryerje me persona tjerë ka kryer veprën penale si në dispozitiv të aktakuzës, ndërsa nga shkresat e lëndës shihet qartë se me të pandehurit tjerë jo që nuk ka bashkëpunuar por as që i njeh fare përveç të akuzuarit S.R., i cili jeton në fshatin “...” dhe është bashkëfshatarë me të njëjtin. Me Samirin ka pasur raporte fqinjësore dhe atë meqë i akuzuari mban një fermë bagëtish, posedon mjete bujqësore dhe për sigurimin e ushqimit të bagëtisë gjatë periudhës dimërore përveç se punon pronën e tij merr me qira edhe pronat e bashkëfshatarëve e ndër ta edhe pronën e S.R., duke i paguar qiranë vjetore.
- Meqë nga provat e administruara shihet se cilësimi juridik është i gabuar, gjykatës i ka propozuar që të bëjë ricilësimin juridik të veprës penale dhe me rastin e shqiptimit të dënimit të ketë parasysh faktet se i pandehuri është baba i dy fëmijëve me profesion bujk, i njëjti merret me kultivimin e bagëtive të cilin burim e ka ekzistencial dhe se pushkën dhjetëshe gjysmë automatike e ka mbajtur meqë gjatë verës del në bjeshkët e Istogut, për t’i mbrojtur bagëtitë nga egërsirat dhe se e njëjta i ka mbetur si trofe nga lufta në Kosovë. Më parë, nuk ka qenë i gjykuar, ndaj tij nuk zhvillohet ndonjë procedurë për ndonjë vepër tjetër penale, andaj i ka

propozuar gjykatës që t'i shqiptojë një dënim me gjobë duke konsideruar se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit.

I akuzuari **A.F.**, respektivisht mbrojtësi i tij, Avokat D. K., në fjalën përfundimtare ka theksuar:

- Pas shumë seancave gjyqësore me asnjë provë materiale nuk është provuar se i mbrojturi i tij ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, ngase të mbrojturit të tij organi i akuzës nuk i ka përshkruar asnjë veprim inkriminues përveç asaj që i janë gjetur dhe sekuestruar si një revole e tipit “Beretta” 9mm, 95 fishekë dhe dy karikator e që arma në fjalë ka qenë me leje e vendosur në sirtar sipas procedurës së përcaktuar në Ligjin për armë me leje valide të lëshuar nga organi kompetent. Më tej ka shtuar se me asnjë provë materiale nuk është vërtetuar përshkrimi faktik si në dispozitiv të aktakuzës gjegjësisht në pikën I. të saj, ngase i mbrojturi i tij paska vepruar sipas marrëveshjes paraprake me të pandehurit e tjerë. Kjo sipas mbrojtjes nuk qëndron sepse personat që përshkruhen si bashkëkryerës, i mbrojturi i tij e njih vetëm B.M. me të cilin kanë pasur marrëdhënie shoqërore e familjare ndërsa personat S. R., I. R. dhe B.H., ka shtuar se me këta të fundit nuk ka pasur asnjë marrëdhënie familjare apo shoqërore.
- I mbrojturi i tij ka pasur biseda me B.M. të cilat biseda kishin qenë rreth shitblerjes së një arme me leje ku ajo shitblerje kishte ndodhur dhe gjithçka kishte qenë e noterizuar te organi kompetent të cilën armë e ka blere personi B. I. i cili po ashtu ka pasur pëlqimin nga organi kompetent për pajisje me leje të armës. Këtu duke shtuar faktin se dispozitat e Ligjit për armë e parashohin se “një person që ka armë me leje mund ta shesë të njëjtën tek një person tjetër i cili ka leje për armë apo pëlqim për pajisje me leje të armës”, pra sipas mbrojtjes, prokuroria në përshkrim të dispozitivit të akuzës nuk ka përshkruar asnjë veprim të mbrojturit të tij se çfarë arme ka siguruar, nga kush, kujt ia ka shitur, çmimin e saj, kohën apo vendim e veprimit inkriminues. Se në këtë çështje nuk janë dëgjuar dëshmitar ngase nuk ka pasur propozime të tilla nga prokuroria, ku kjo vërteton se organi akuzës nuk ka arritur të siguroj së paku as një dëshmitar në lidhje me këtë rast. Mbrojtja krejt në fund ka kërkuar nga gjykata që të merr aktgjykim lirues për të mbrojturin e tij, sepse nuk është provuar se i njëjti ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet dhe të vendos lidhur me kthimin e armës së sekuestruar sepse e njëjta ka leje valide nga organi kompetent.

I akuzuari **A.C.**, respektivisht mbrojtësi i tij, Avokat A. M. në fjalën përfundimtare ka theksuar:

- Nga provat e administruara nuk rezultojë të jetë gjetur ndonjë armë tek A., ashtu siç dhe ka deklaruar në prokurori vet i pandehuri se në vitin 2019, ka qenë i interesuar ta blej një revole "TT" me çmim prej 750 Euro nga B.M., të cilin e ka njohur, kur ai ka shkuar për t'i qethur flokët në dyqanin e A. i cili e kishte pyetur nëse ka interesim për armë dhe duke menduar se do jetë më i sigurt të ketë një armë ka shpreh interesim, andaj dhe i dërgon në telefon një foto të armës, por që kjo shitblerje nuk ishte realizuar asnjëherë, derisa të pandehurit tjerë nuk i njeh dhe se asnjëherë as si ka takuar apo kontaktuar me ndonjërin nga ata. Si dhe provohet nga vet mbrojtja e tyre e dhënë në procedurë hetimore dhe raporti përmbledhës i komunikimeve. Andaj, këtu si veprim i vetëm i tij, mbeti asgjë tjetër pos interesimit, veprim i cili as vet ligjvënësi nuk e përcakton si veprim inkriminues.
- Një foto e gjetur e një arme që asnjëherë nuk e posedon, nuk mund të jetë as indicie për hetim apo të ketë një dyshim të arsyeshëm, e lërë më dyshim të bazuar mirë për ngritje të akuzës. Prokurori në përmbledhje të fakteve, nuk dha arsyetim se cilat prova, provuan veprimin inkriminues të këtu të pandehurit C. Përgjimet si prova materiale, padyshim se do forconin tezën e akuzës, sikur dhe një e vetme të gjendej në raportin përmbledhës. Nuk është kontestuese se tek disa të pandehur të jenë gjetur dhe sekuestruar armë, por është obligim i prokurorisë të ndaj veprimet e secilit mbi bazën e të provuarit, nuk mund të ngarkohen me veprime të përgjithësuara, sepse interesimi për të blerë armë, ligji nuk e përcakton si veprim inkriminues, përkatësisht cilat prova vërtetuan se i pandehuri A., përpos interesimit për të blerë një armë, shitblerjen që pretendohet në akuzë.
- Me bindje të thellë e them se A., mezi siguron kafshatën e bukës me zanatin e floktarit. Për të mbajtur familjen dhe sikur të merrej me shitblerje të armëve sigurisht se gjendja e tij ekonomike do të ishte ndryshe. Pra prokuroria jo vetëm që nuk mundi të argumentoj shitblerjen e asnjë të vetmes armë edhe pse për tu plotësuar forma e kryerjes së kësaj veprë penale, sigurisht se ligjvënësi se ka menduar blerjen e vetëm një arme që as ajo nuk është realizuar, por shitblerjen e ka paraparë të jetë në masë dhe atë të jetë e ndërlidhur me forma tjera cilën do qoftë, pra e që nënkupton, importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar.
- Të ngritet një aktakuzë nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, për një veprë të tillë penale në raport me të pandehurin A., vetëm pse ishte i interesuar të blinte një armë, kjo mbetet për tu vlerësuar nga ana e gjykatës. Duke pasur parasysh se për të vërtetuar ndonjë nga elementet e veprës penale, duhet të mbulohet me prova, prova të cilat saktë e në mënyrë të plotë do vërtetonin secilin

veprim për secilin të pandehur, edhe sikur të kishte këtu i pandehuri ndonjë komunikim, për çdo formë të veprës penale, patjetër se ka qenë obligim i prokurorisë, ato t'i ndërlihdh. Pra, kush transportojë, kush ndërmjetësojë, kush i bleu, ku i bleu, cili ishte çmimi, për çfarë qëllimi bleu, veprime të cilat nuk u konkretizuan së paku në raport me të pandehurin C., andaj ka theksuar se i vetmi propozim i mbrojtjes është lirimi nga aktakuza në mungesë të provave për të vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se është kryes i veprës penale për të cilën është akuzuar.

I akuzuari **K.S.**, respektivisht mbrojtësja e tij, Avokate M. B., në fjalën përfundimtare ka theksuar:

- Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale, ka parashtruar të gjitha kundërshtimet në kuptim të mbrojtjes pasi që aktakuza e ngritur ndaj të mbrojturit të saj, K.S., për veprën penale për të cilën i njëjti akuzohet nuk qëndron pasi që prokuroria në mbështetje të aktakuzës nuk ka propozuar asnjë dëshmitar, përveç atyre provave që janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor e të cilat prova nuk vërtetojnë se i mbrojturi i saj të këtë kryer veprën penale për të cilën akuzohet dhe nuk ka kurrfarë pretendime që i mbrojturi i saj të këtë bërë përpjekje për sigurimin e armëve për shitblerje apo diçka tjetër të ngjashme për qëllime përfitimi dhe se asnjërin nga të akuzuarit nuk e njeh, ndërsa fishekët të cilët janë gjetur tek i mbrojturi saj thekson se nuk kanë të bëjnë me këtë vepër penale. Fishekët janë gjetur në një shtëpi të djegur gjatë luftës dhe në momentin që kishte shkuar policia dhe i kanë bastisur shtëpinë, pasi që të të njëjtit e kishin pyetur se a ka diçka të jashtëligjshme në shtëpi, i mbrojturi i saj u'a kishte dorëzuar fishekët të cilët i kishte gjetur në një shtëpi të kallur të serbit gjatë luftës dhe vullnetarisht i kishte dorëzuar.
- Ndërsa sa i përket bisedës me I. me të cilën ka theksuar se janë fqinjë dhe shesin gjëra ushqimore dhe me djemtë e saj është rritur bashkë dhe se sa i përket shumë prej 320 €uro, kjo shumë ka pasur të bëjë me motor sharre e jo për ndonjë armë ose diçka të ngjashme. Dhe në fund i ka propozuar gjykatës që të mbrojturin e saj ta lirojë nga akuza pasi që nuk ka prova të mjaftueshme që i njëjti të këtë kryer veprën penale për të cilën akuzohet e nëse gjykata vlerëson se i njëjti ka kryer veprën penale, atëherë të merr parasysh rrethanat lehtësuese pasi që i njëjti nuk është dënuar asnjëherë me parë për ndonjë vepër penale dhe as nuk dyshohet. Ka qenë korrekt e prezent në shqyrtime gjyqësore dhe është mbajtës i familjes, ku çdo dënim eventual do të ishte dënim për tërë familjen.

I akuzuari **B.H.**, respektivisht mbrojtësi i tij, Avokat A. T. në fjalën përfundimtare ka theksuar:

- Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale dhe administrimit të provave nga prokuroria, nuk është vërtetuar fajësia e të mbrojturit të tij B.H., ngase kjo aktakuzë nuk ka mbështetje në prova dhe i mungon identiteti objektiv e subjektiv dhe se për veprën penale e cila i vihet në barrë të mbrojturit të tij, nuk janë plotësuar parakushtet ligjore të veprës penale bazë, kushti themelor si elementi subjektiv i fajësisë-dashja. Po ashtu nuk ka as prova materiale e as formale që të formohet figura e veprës penale me të cilën ngarkohet i mbrojturi i tij. Ndërsa sa i përket përgjimit të telefonit të mbrojturit të tij, ka theksuar se është bërë pa aktvendim për fillim të hetimeve e i njëjti përmendet vetëm në kallëzimin penal e në arsyetim të aktvendimit të personave të tjerë dhe se në shkresat e lëndës nuk ka urdhëresë për përgjim të telefonit për të mbrojturin e tij dhe përkundër kësaj, gjatë aplikimit të masave të fshehta të hetimit e vëzhgimit dhe gjatë ekzaminimit të telefonit mobil, nuk është gjetur asgjë ndaj të mbrojturit të tij që bie ndesh me ligjin.

- Tuje ka shtuar se prokuroria përshkrimin e gjendjes faktike e ka bërë vetëm duke i parafrazuar veprimet e elementet e veprës penale sipas dispozitës së nenit 364 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 e lidhur me nenin 31 të KPRK, por jo edhe përshkrimin real se: ku, si, me kënd, kur, në çfarë mënyrë, cilin vend, kohën kontaktin etj. Nuk kemi as veprimin e kryerjes së veprës penale e as dashjen për kryerjen e kësaj vepre dhe thekson se këtë e vërteton edhe fakti se me asnjë provë të vetme nuk vërtetohet se mbrojturi i tij të jetë inkriminuar në këtë vepër penale. Nuk ekziston vepër penale, vetëm e vetëm se ka qenë i dënuar më parë për vepër të ngjashme, e duke u bazuar në provën e vetme të cilën e ka propozuar prokuroria që të administrohet e njëjta provë është marrë në kundërshtim me procedurat sipas KPPRK dhe është e papranueshme, ku e njëjta nuk e ka fuqinë e të provuarit pasi që nuk mund të jenë të vetmet prova për ta mbështetur aktin akuzues. Kjo aktakuzë bie ndesh me ligjin dhe në këtë rast vlen parimi ”*Nulum Crimen Nula Poena Sine Lege*”.

- Mbrojtja tutje ka shtuar se i akuzuari B.H., nuk ka pasur asnjë qëllim e as dashje për të kryer njërin nga elementet e veprës penale si: import, eksport, furnizim, transportim, prodhim, këmbim, ndërmjetësim, ose shitja të pa autorizuar të armëve dhe se aktakuza në asnjë pjesë të saj nuk përshkruhet sipas emërimit ligjor. Të gjitha emërtimet janë abstrakte dhe si të tilla nuk qëndrojnë, duke shtuar edhe faktin se i mbrojturi i tij nuk e njeh asnjërin nga të akuzuarit e aq më pak të kishte pasur marrëveshje paraprake dhe po ashtu edhe gjatë bastisjes mbrojtja ka theksuar se nuk është gjetur asgjë e dyshimtë apo mjete të kundërligjshme dhe në fund i ka propozuar gjykatës që pas analizimit e vlerësimit të provave ndaj të mbrojturit të tij, pasi që nuk është vërtetuar asnjë element i veprës penale, gjykata bazuar në

nenin 363 paragrafi 1 pika 1.3 të KPPRK të nxjerr aktgjykim lirues. Po ashtu ka propozuar që edhe t'i kthehet telefoni mobil i sekuestruar.

I akuzuari **P.M.**, respektivisht mbrojtësi i tij, Avokat T. I. në fjalën përfundimtare ka theksuar:

- Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, me asnjë provë të vetme nuk e ka bërë të besueshme akuzën dhe nuk ka vërtetuar faktin se i mbrojturi i tij e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, pasi që për këtë çështje ndaj tij nuk ka: asnjë dëshmitar; as ndonjë provë materiale; SMS; biseda telefonike; foto të të mbrojturit të tij; përgjime apo ndonjë takim i mundshëm për të cilën pretendon prokuroria. Po ashtu gjatë bastisjes së banesës së tij dhe tek shtëpia e babit të tij, jo që nuk është gjetur ndonjë armë por as ndonjë gjë tjetër që do të ishte në kundërshtim me ligjin.
- Provën e vetëm të cilën prokuroria pretendon se e ka është një bisedë telefonike mes të mbrojturit të tij dhe të akuzuarit B.M. të cilën e ka shpjeguar në seancë ku është një telefonatë që ka të bëjë rreth një televizor të të mbrojturit të tij, fakt ky i cili mund të vërtetohet nga përgjimi i asaj bisede. Po ashtu siç ka theksuar i mbrojturi i tij me asnjë nga të akuzuarit nuk njihet dhe asnjëri nga ta nuk e përmend emrin e të njëjtit. Ashtu që i mbrojturi i tij lidhur me akuzën që e rëndon ndihet dhe është i pafajshëm, në fund i ka propozuar gjykatës që ndaj të mbrojturit të tij në mungesë të provave, përkatësisht faktin se nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale e duke iu referuar nenit 363 të KPRK, ndaj të mbrojturit të tij të nxirret aktgjykim lirues.

I akuzuari **F.P.**, respektivisht mbrojtësi i tij, Avokat O. H. në fjalën përfundimtare ka theksuar:

- Pas përfundimit të luftës në Kosovës, rreth vitit 2000 babai i të mbrojturit të tij R. P., tani i ndjerë kishte jetuar së bashku me familjen e tij në B. të P. dhe i përkisnin komunitetit boshnjak andaj për shkak të gjuhës që e flisnin serbo-boshnjake babai i tij ishte i pa sigurt nga personat që nuk e njihnin e që për shkaqe sigurie kishte vendosur për të blerë një armë automatike të tipit “Zastava” me dy karikator në shumën prej 1200 Euro, e që në vitin 2012, babai i të mbrojturit të tij kishte ndërruar jetë dhe arma i kishte mbetur familjes së tij me këtë rast i mbrojturi i tij në vitin 2020, ishte interesuar që armën në fjalë të ia jep apo eventualisht të ia shesë dikujt me një çmim edhe simbolik meqenëse në Kosovë në atë kohë ishte krijuar një siguri dhe që ta mbante armën më ishte e panevojshme. Lidhur me këtë situatë i mbrojturi i tij duke biseduar me bashkë vendasin e tij S., ky i fundit i kishte thënë se për hatër do ta marr armën do ta heqi brengën e që nga kjo situatë

shihet se nuk ishte çështje tregtie por që vërtet ishte çështje halli të cilën armë ia kishte shitur në vlerë, shumë simbolike 350 Euro. Mbrojtja më tej ka elaboruar çështjen e bashkëkryerjes duke theksuar se nuk është vërtetuar nga faktet dhe provat konkrete e as edhe në shqyrtimin gjyqësor se ishte involvuar i mbrojturi i tij në tregti me armë me nëntëmbëdhjetë bashkë të akuzuar e që asnjëri nga këta të fundit nuk e kanë përmendur emrin e tij e as që ka rezultuar se njëhej me ta përveç me S.R.

- Se prokuroria të mbrojturin e tij e ka ngarkuar vetëm mbi bazën e një bisede, transkripti i cili e ka zhvilluar me tani të akuzuarin S.R., se të mbrojturit të tij nuk i është marr apo sekuestruar ndonjë armë andaj edhe nuk është vërtetuar fajësia e tij përtej dyshimit të bazuar me prova të pakontestueshme i cili dyshim i bazuar fortë mire duhet të ishte gurë themeltar për të proceduar më tutje dhe për të kërkuar llogari dhënie për ta shpallur fajtor të njëjtin. Më tej mbrojtja ka theksuar se gjendja shëndetësore nga inicimi i rastit e deri më tani të mbrojturin e tij e ka tronditur shumë për të cilën gjykatës i ka dorëzuar edhe dokumentacion mjekësor. Krejt në fund mbrojtësi ka kërkuar nga gjykata që të mbrojturin e tij ta liroj nga akuza për faktin se nga provat e pretenduara nga prokuroria nuk është vërtetuar-provuar përtej dyshimit të bazuar se i njëjti ka kryer veprën penale që ka të bëjë me veprat penale të armëve, njeherit ka kërkuar që bazuar në dispozitat ligjore shumë prej 2000 Euro të cilat i janë marr në shtëpi të mbrojturit të tij ti kthehen sepse ato nuk rrjedhin nga ndonjë veprë penale për të cilën i mbrojturi i tij prokurorisë dhe gjykatës i ka ofruar dëshmi me raporte bankare se ato i përkasin atij dhe familjes së tij.

I akuzuari **F.A.**, respektivisht mbrojtësi i tij, Avokati J. I. në fjalën përfundimtare ka theksuar:

- Pas përfundimit të kësaj çështje penale, gjatë seancave gjyqësore të mbajtura në këtë çështje penale, provat të cilat janë propozuar nga ana e akuzës ashtu edhe provat materiale shkojnë në favor të mbrojturit të tij dhe po ashtu edhe nga deklarata e të mbrojturit të tij, duke përfshirë edhe përgjimet telefonike dhe fotot në vëzhgimin e vendit të ngjarjes, del se përveç shitblerjes së automjetit që kishte me të akuzuarin H.N., pasi që i mbrojturi i tij herë pas here ishte marrë me shitblerjen e automjeteve dhe posedon një kompani për asfaltimin e rrugëve e një pompë të karburanteve, ashtu që asnjë raport tjetër nuk kishte që mund të vërtetonte të kundërtën, të cilin fakt i mbrojturi i tij e kishte deklaruar edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor. Tutje mbrojtja ka shtuar se nuk është kontestuese fakti se në shtëpinë e të mbrojturit të tij janë gjetur dhe sekuestruar dy armë të gjuetisë, por

për të cilat i mbrojturi tij ka poseduar leje valide e të cilat armë janë sekuestruar jashtëligjshëm.

- Mbrojtja ka shtuar se provat e propozuara mund të jenë prova që mbështesin dyshimin e arsyeshëm, por jo edhe prova të bazuara për vërtetimin e fajësisë për të mbrojturin e tij, ngase i mbrojturi tij në çdo fazë të procedurës ka mohuar një barrë të tillë dhe me prova të tjera nuk vërtetohet që i mbrojturi i tij të ketë kryer veprën penale për të cilën akuzohet dhe nisur nga Instituti juridiko procedural “*In Dubio Pro Reo*”, provat të cilat nuk kanë mundur të vërtetohen në plotni të njëjtat do të duhej të vlerësohen në favor të të mbrojturit të tij dhe pretendimet e akuzës mbeten nën efektin e supozimit dhe krejtësisht abstrakte. Në fund i ka propozuar gjykatës që ndaj të mbrojturit të tij gjykata të merr aktgjykim lirues, konform nenit 363 paragrafi 1 pika 1.3 të KPPRK si dhe të mbrojturit të tij t’i kthehen sendet të cilat i janë sekuestruar.

I akuzuari **S.N.**, respektivisht mbrojtësja e tij, Avokatja F. H. në fjalën përfundimtare ka theksuar:

- Pas përfundimit të kësaj çështje penale dhe pas zhvillimit të procedurës së administrimit të provave materiale, mbrojtja konsideron se prokuroria nuk ka arritur të dëshmojë se me veprimet e tij i mbrojturi i saj S.N. me dashje dhe qëllim të caktuar të ketë kryer veprën penale siç pretendohet në aktakuzë, sepse në asnjë mënyrë me të pandehurit nuk ka importuar, eksportuar, furnizuar, transportuar, prodhuar, këmbyer apo ndërmjetësuar dhe nuk ka shitur në mënyrë të paautorizuar armët apo materialet plasëse dhe se armët të cilat i janë gjetur në shtëpinë e tij. Gjatë bastisje kanë qenë një pushkë gjuetie të cilën ka dashur ta legalizoje e një pistolete e cila ka qenë jashtë funksionit dhe ka theksuar se prokuroria e ka ngarkuar gabimisht me veprën penale me të cilën ngarkohet në mënyrë të përgjithësuar, veçmas duke ia veshur katër armë, ndërsa komunikimet të cilat i ka bërë me telefon kanë qenë për shkak se ai punon si bletar dhe ka komunikuar me njerëz për shkak të shitjes së mjaltit.
- Tutje mbrojtja ka shtuar se në asnjë moment nuk është arritur bazueshmëria e veprës penale në bashkëkryerje, bashkëkryerje nuk ka, e sikur ajo të ekzistonte prokuroria është dashur secilit bashkëkryes t’ia caktonte përgjegjësinë penale brenda kufijve të dashjes dhe se prokuroria e ka ngarkuar të mbrojturin e saj me veprën penale duke mos specifikuar fare objektin, mjetin e rrethanat si dhe nuk është plotësuar figura e veprës penale. Elementi bazë subjektiv i dashjes mungon, asgjë nuk është saktësuar as individualizuar. Andaj në fund ka kërkuar nga gjykata që me rastin e vendosjes të ketë parasysh parimin “*In dubio pro reo*” dhe të gjitha

mëdyshjet e faktet vendimtare t'i interpreton në favor të mbrojturit të saj dhe ndaj të njëjtit për shkak që nuk është dëshmuar fajësia të merr edhe aktgjykim lirues.

I akuzuari **T.K.**, respektivisht mbrojtësi i tij, Avokat B. M. në fjalën përfundimtare ka theksuar:

- Të gjithë pjesëmarrësit në gjykim që nga dita e parë e deri në shqyrtimin e fundit gjyqësor ka qenë e qartë se i mbrojturi i tij nuk do të duhej të ishte i akuzuar sepse pas administrimit të provave është më se e qartë se i mbrojturi i tij ka qenë dhe është viktimë e atyre që e kanë sjell deri këtu, sepse me asnjë provë konkrete të mundshme e relevante nuk e vërteton se i njëjti e ka kryer veprën penale e cila i është vënë në barrë sipas aktakuzës. Duke shtuar se aktakuza e prokurorisë do të duhej të hidhej me kohë pasi që nuk i plotëson as për së afërmi konditat nga neni 235 KPRK, sepse prokuroria ka dështuar në këtë rast duke ngritur aktakuzë të paqëndrueshme, të pabazuar në ligj e as në prova. Aktakuza e prokurorisë kundrejt të mbrojturit të tij nuk mund të qëndroj juridikisht e faktikisht, sepse nga provat e ofruara nga organi akuzës për vërtetimin e veprimeve inkriminuese si në dispozitivin e saj të cilat janë administruar në shqyrtim gjyqësor nuk kanë provuar pretendimet nga aktakuza si dhe kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet. Kjo vërtetohet edhe me provat e administruara në shqyrtim gjyqësor. Mbrojtësi më tej ka theksuar se i mbrojturi i tij ngarkohet për veprën penale që fare nuk e ka kryer e për të cilën prokuroria nuk ka ofruar asnjë provë të vetme të mundshme e relevante, sepse lidhur me këtë nuk ka as datë, ditë, kohë e as vend të kryerjes së saj, madje i mungon edhe individualizimi i saj, pra asgjë nuk është saktësuar e precizuar.
- Mbrojtësi konsideron se prokuroria ka shkelur dispozitën e nenit 7 të KPPRK e cila dispozitë paraqet dyshim të përgjithshëm për vërtetimin e plotë dhe të saktë të fakteve të organeve të drejtësisë të cilat marrin pjesë në procedure penale pasi që detyrohen që saktësisht dhe tërësisht t'i vërtetojnë faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e një vendimi të ligjshëm. Gjithashtu ka theksuar se prokuroria ka dështuar edhe në mos respektimin e dispozitës të nenit 47 të KPPRK të cilat e detyrojnë që të analizojnë provat dhe faktet si ato fajësuese e shfajësuese, si dhe të sigurojnë që hetimi të kryer duke respektuar në tërësi të drejtat e të pandehurit konform dispozitave ligjore vendore edhe ndërkombëtare. Mbrojtja më tej ka shtuar se gjykata duhet të ketë parasysh nenin 3 të KPPRK, lidhur me institutin e prezumimit të pafajësisë së të pandehurit kur qartë ky institut "In dubio pro reo" vlen parimi se çdo person i dyshuar ose që akuzohet për vepër penale konsiderohet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia e tij me aktgjykim të formës së prere. Kjo dispozitë interpretohen në favor të të mbrojturit të tij dhe të drejtave

të tij sipas Kodit Procedurës Penale dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës, që do të thotë që në mungesë të provave të vendoset në favor të të mbrojturit të tij.

- Mbrojtësi më tej ka theksuar se asnjëri nga të pranishmit në këtë rast nuk e ka përmendur apo ngarkuar të mbrojturin e tij apo të ketë pasur diçka të përbashkët në lidhje me veprën për të cilën akuzohet. I njëjti krejt në fund ka propozuar që ndaj të mbrojturit të tij gjykata të merr aktgjykim lirues sepse me asnjë mënyrë nuk është provuar dhe nuk ka mundur të provohet se ai të ketë kryer veprën penale për të cilën akuzohet pa asnjë bazë.

I akuzuari **B.B.**, respektivisht mbrojtësi i tij, Avokat Sh. Z. në fjalën përfundimtare ka theksuar:

- Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale nga përshkrimi i prezantuar i gjendjes faktike të veprës penale të përshkruar sipas aktakuzës e cila vepër penale i vihet në barrë të mbrojturit të tij, nuk rezulton se në veprimet e tij janë përmbushur elementet e veprës penale, për faktin se edhe vet prokuroria në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se nuk ka të bëjë me vepër penale në bashkëkryerje ashtu siç akuzohet i mbrojturi i tij. Po ashtu ka shtuar se nuk ekziston as lidhja logjike e as faktike mes përshkrimit të veprimeve si në aktakuzë e as nga provat të cilat prokuroria e ka mbështetë bazueshmerine e aktit akuzues dhe po ashtu aktakuzës i mungon identiteti objektiv dhe subjektiv.
- Tutje ka shtuar se prokuroria përshkrimin e gjendjes faktike të veprimeve e ka bërë vetëm duke i parafrazuar veprimet dhe elementet e veprës penale sipas dispozitës së nenit 364 paragrafi 2 lidhur me paragrafi 1 e lidhur me nenin 31 të KPRK, por jo edhe përshkrimin real se: ku; si; me kënd; kur; në ç'mënyrë; cilin vend; kohën kontaktin etj.
- Nuk kemi as veprimin e kryerjes së veprës penale e as dashjen për kryerjen e kësaj vepre dhe thekson se këtë e vërteton edhe fakti se me asnjë provë të vetme nuk vërtetohet se mbrojturi i tij të jetë inkriminuar në këtë vepër penale, se nuk ekziston vepër penale, vetëm e vetëm se ka qene i dënuar më parë për vepër të ngjashme dhe duke u bazuar në provën e vetme të cilën e ka propozuar prokuroria që të administrohet, ku e njëjta provë është marrë në kundërshtim me procedurat sipas KPPRK. Kjo aktakuzë bie ndesh me ligjin dhe në këtë rast vlen parimi "Nullum Crimen Nulla Poena Sine Lege" dhe po ashtu gjykatës i ka propozuar që të bëjë ri-cilësimin juridik të veprës penale nga neni 364 në nenin 366 të KPPRK dhe në këtë mënyrë do të shkonin me pranimin të fajësisë gjë të cilën ka theksuar se e kanë kërkuar qysh në fillim të kësaj procedure penale. Në fund ka kërkuar nga gjykata që ndaj të mbrojturit të tij B.B. të bie aktgjykim lirues. Ose nëse bëhet ri-cilësimi i veprës penale, atëherë të marr si rrethane lehtësuese pranimin e fajësisë.

I akuzuari **H.N.**, respektivisht mbrojtësja e tij, Avokate L. D. P. në fjalën përfundimtare ka theksuar:

- Në bazë të provave materiale të cilat janë propozuar në aktakuzë dhe që janë shqyrtuar në shqyrtim gjyqësor duke përfshirë edhe dëgjimin e bashkëpandehurit dhe gjitha shkresave tjera të lëndës, është vërtetuar në mënyrë të pakontestueshme se i mbrojturi i saj nuk ka kryer veprën penale nga neni 364 paragrafi 2 lidh me paragrafin 1 dhe nenin 31 të KPRK, sepse nuk janë plotësuar asnjë nga elementet që e përbëjnë veprën penale të cekur më lartë siç janë veprimi, kundërligjshmëria, përcaktueshmëria dhe fajësia, e të cilat veprimet duhet të përmbushen në mënyrë kumulative ngase mungesa e njërit element do të thotë se nuk ekziston vepra penale e që gjatë gjykimit nuk është vërtetuar elementi subjektiv, përkatësisht fajësia si dhe elementi objektiv që është kundërligjshmëria, pasi që e njëjta nuk ka mundur të vërtetohet në bazë të rrethanave faktike.
- Me asnjë provë materiale dhe personale nuk është vërtetuar fajësia, sepse i mbrojturi i saj as që ka poseduar armë gjë e cila vërtetohet edhe nga procesverbali i bastisjes së shtëpisë. Se gjatë gjithë procesit gjyqësor është dashur të vërtetohet fajësia e të mbrojturit të saj si element i veprës penale, përkatësisht dashja e që me dashje direkte është e domosdoshme që ai të jetë i vetëdijshëm për veprën e tij dhe ta ketë dëshiruar kryerjen e saj, ku duhet të shprehet elementi intelektual dhe ai volutiv e që në mungesë të fajit, kryerësi nuk mund të dënohet përndryshe do të shkelet parimi bazë që është “nullum crimen nulla sine culpa” që do të thotë se gjykata nuk ka të drejtë të dënoj askënd të pafajshëm, ku gjatë gjithë procesit nuk është paraqitur asnjë fakt apo asnjë provë materiale me peshë provuese me të cilën do të vërtetohej fajësia e të mbrojturit të saj apo përfshirjen e tij në një vepër penale. Nuk ka pasur asnjë dëshmitar kundër tij dhe në deklaratat e bashkëpandehurve, ku tre prej tyre kanë deklaruar se të mbrojturin e saj e njohin, sepse kanë shkuar për të blerë pjesë të automjeteve pasi që djali i tij është automekanik.
- Aktakuza është në kundërshtim me dispozitën e nenit 7 paragrafi 1 dhe 2 të KPRK, për shkak se kjo dispozitë e obligon prokurorinë që t'i vërtetojë faktet saktësisht me vëmendje, përkushtim maksimal, profesional dhe përkujdesje të njëjtë t'i vërtetojë faktet kundër të pandehurit si dhe ato që janë në favor të të pandehurit se gjithashtu aktakuza është në kundërshtim me nenin 19 paragrafin 1 nën paragrafi 1.8, 1.9 e 1.12 të KPPRK, për shkak se në këtë rast nuk është arsyetuar dyshimi i arsyeshëm, sepse nga të gjitha provat e pranuar nga prokuroria nuk është arsyetuar dyshimi i bazuar se i mbrojturi i saj ka kryer veprën penale për të cilën

edhe akuzohet, e në të cilën aktakuzë prokuroria nuk ka treguar se cilat veprime i ka ndërmarr i njëjti. I mbrojturi i saj nuk e ka kryer veprën penale në fjalë vërtetohet edhe me rastin e bastisjes së shtëpisë së tij në të cilën nuk është gjetur asgjë e paligjshme e as edhe një armë.

- Mbrojtja ka elaboruar edhe çështjen e provave në këtë çështje penale duke konsideruar se në shkresat e lëndës sa i përket të mbrojturit të saj ato prova janë thellësisht të pa mbështetshme për veprën për të cilën akuzohet dhe nuk dëshmojnë se i njëjti ka kryer atë vepër penale e që askund e as në dispozitiv të aktakuzës nuk është theksuar si është kryer vepra penale nga i mbrojturi i saj, por vetëm është mjaftuar me përkrahje të dispozitës ligjore. Sa i përket pretendimit të prokurorisë për bashkëkryerjen, ky është një pretendim i pabazuar dhe arbitrar sepse për të ekzistuar bashkëkryerja duhet që personat të kontribuojnë thellësisht në kryerjen e veprës penale, të japin kontributin e tyre, ta dëshirojnë ndërmarrjen e veprimeve të përbashkëta, të ekzistoj një lloj marrëveshje paraprake për të kryer një vepër penale, e që për të ekzistuar bashkëkryerja sipas prokurorisë duhet të përmbushen elementet subjektive e objektive e që vet prokuroria gjatë shqyrtimit gjyqësor ka pranuar se të pandehurit nuk njihen në mes vete e të cilët janë akuzuar për bashkëkryerje, kurse për të ekzistuar bashkëkryerja duhet të ekzistoj marrëveshje paraprake për të kryer vepër penale, të ndahen rolet e që në këtë rast i mbrojturi i saj nuk njihet me të pandehurit.
- Prokuroria me akuzën e ngritur ndaj të mbrojturit të saj nuk ka arritur të sqaroj se cilat veprimet i ka ndërmarr për të kryer veprën penale për të cilën akuzohet e as nuk e ka përcaktuar në asnjë rast se çka ka importuar i njëjti, kujt i ka importuar, çka ka furnizuar dhe kujt. Duke shtuar se gjatë dëgjimit të bashkakuzuarve shihet se ishte armiqësore ndaj të mbrojturit të saj, andaj bazuar edhe në dispozitën e nenit 119 paragrafi 5 të KPRK, deklaratat e dhëna nga i pandehuri në çfarëdo kontesti janë prova të pa pranueshme dhe nuk mund të shërbejnë apo përdoren si prova ndaj të bashkakuzuarve të tjerë në të njëjtën procedure penale. Më tej mbrojtësja ka shtuar se sa i përket deklaratave të bashkakuzuarve që e njohin të mbrojturin e saj është vërtetuar pa dyshim se ata njihen mes vete dhe se kanë shkuar në vende të ndryshme për të blerë pjesë të veturave, por në asnjë formë nuk kanë ndërmarr asnjë veprim të kundërligjshëm ashtu siç ka pretenduar prokuroria. Mbrojtja kërkon nga gjykata që të zbatohet nenin 1 paragrafi 2, nenin 3, nenin 5, nenin 7 e 9 të KPPRK si dhe nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në fund nenin 363 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPPRK, duke marrë aktgjykimin lirues ndaj të mbrojturit të saj, sepse nuk është provuar se i mbrojturi i saj ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari **H.A.**, respektivisht mbrojtësja e tij, Avokate T. Zh. në fjalën përfundimtare ka theksuar:

- Mbrojtja nuk është e mendimit se qëndron as kualifikimi juridik i ri-kualifikuar nga prokuroria, duke pas parasysh faktet e hetuara si dhe provat e prezantuara nga prokuroria duke konsideruar se i gjithë hetimi lëngon esencialisht nga të metat themelore në lidhje me kualifikimin ligjor duke theksuar se prokuroria ka dështuar që të argumentoj se i mbrojturi i saj të ketë kryer veprën penale nga neni 364 paragrafi 2 e lidhur me nenin 31 të KPRK, që paraqet veprimet bashkëkryerëse si formë e kualifikimit bazë. Se organi i ndjekjes me asnjë fakt, provë, apo dëshmi konkrete nuk ka arritur të vërtetoj tezën e akuzës në lidhje me veprimet e të mbrojturit të saj ku rrjedhimisht nuk qëndron fakti se i mbrojturi i saj të ketë kryer veprën penale me të cilën ngarkohet.
- Mbrojtësja më tej ka theksuar se prokuroria nuk ka arritur të vërtetoj me asnjë fakt ligjor lidhshmërinë e të mbrojturit të saj me cilindo nga personat e përmendur në aktakuzë e që as kualifikimi ligjor i veprës penale në bashkëkryerje nuk qëndron në asnjë fakt dhe asnjë dëshmi, andaj për mbrojtjen as nuk është kuptuar se pse prokuroria e ka cilësuar si të tillë. Gjithashtu mbrojtja nuk e ka kuptuar fare se në cilën kohë, cilën periudhë, cilat veprime konkrete dhe të dëshmuara nga i mbrojturi i saj ka mundur që të kryej veprën penale e cila i është vënë në barrë ku edhe gjatë gjyqimit nuk janë vërtetuar supozimet e prokurorit të ndjekjes penale se këta persona kishin vepruar në bashkëkryerje ngase shumica e personave në aktakuzë nuk njihen mes veti, shtuar faktin këtu se të gjitha veprat penale të cilat mund të kryhen në bashkëkryerje element të përbashkët e kanë veprimin konkret me personat e tjerë me të cilët duhet të njihen mirë, duhet të bashkërendojnë veprimet e tyre dhe me dashje të kontribuojnë për të kryer një vepër penale.
- Organi i ndjekjes ka mbetur borxh që t'i arsyetoj se cilat ishin rezultatet e bisedave telefonike se cilat ishin ato biseda që ishin realizuar dhe se çka ka rezultuar nga ato ku në rastin konkret të mbrojturit të saj nuk i është dëshmuar me asnjë provë konkrete se pas ndonjërës bisede ka rezultuar një veprim konkret ose se te i njëjti është gjetur ndonjëri nga sendet e biseduara nga përgjimet. Mbrojtësja ka elaboruar edhe disa nga aspektet e konstatimit të gjendjes faktike ku sipas prokurorisë ka pas disa dyshime fillestare se i njëjti ka lëvizur në kufirin e ligjit ngase bisedat telefonike të përgjuara nuk kanë dhënë asnjë provë, rezultat apo çfarëdo dyshimi. Mbrojtja konsideron se prokuroria pas asnjë bazë juridike ka ngritur aktin akuzues ndaj të mbrojturit të saj ku është theksuar se “në pronën e H.A. janë gjetur një pushkë, 104 fishekë, një revole e gasit e tipit Zoraki etj.”, mirëpo ky cilësim është

i gabuar sepse në procesverbalin mbi bastisje rrjedh se në pronën e të mbrojturit të saj nuk është gjetur asgjë inkriminuese.

- Palët nuk kanë për detyrë që të siguroj provat ose dëshmitë për organet e tjera por që të kërkojë nga ato t'i ofrojmë prova dhe dëshmi për një proces të rregullt dhe të drejte ligjor e që në rastin konkret kjo nuk kishte ndodhur sa i përket të mbrojturit të saj duke pas parasysh se organi i ndjekjes nuk ka arritur të siguroj asnjë dëshmi, as biseda telefonike, asnjë provë fizike, nuk ka siguruar asnjë moment të shitjes ose blerjes, nuk ka dëshmuar nëse i njëjti më parë është marr me veprime konkrete të kësaj natyre, nuk ka siguruar asnjë deklaratë fajësuese qofte nga një i vetëm dëshmitar, nuk ka realizuar asnjë lloj rasti të simulimit i cili do të faktonte një veprim konkret të tij në drejtim të veprës penale në fjalë e as nuk ka siguruar ndonjë provë të natyrës tjetër qoft forenzike. Mbrojtësja krejt në fund i ka propozuar gjykatës që të nxjerr aktgjykim lirues në mungesë të provave dhe për shkak se veprimet e të mbrojturit të saj nuk përbëjnë vepër penale.

I akuzuari **A.M.**, respektivisht mbrojtësi i tij, Avokat S. S. në fjalën përfundimtare ka theksuar:

- Në shqyrtimin fillestar i mbrojturi i tij ka deklaruar se nuk ndihet i fajshëm, pastaj në seancat në vazhdimësi janë paraqitur të gjitha provat e nevojshme të propozuara nga të gjitha palët, ashtu që nga të gjitha provat e shqyrtuara ka ardhur në përfundim se i mbrojturi i tij nuk ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. I akuzuari A.M. në deklaratën e dhënë në polici ka deklaruar se e njuh të akuzuarin tjetër T.K., kishte kontaktuar me telefon me T. dhe kishte shkuar tek shtëpia e tij për të blerë një veturë "Audi", pasi që vëllau i të mbrojturit të tij e ka një autoservis dhe qëllimi i blerjes së kësaj veture të vjetër ishte se atyre u duheshin pjesë të tilla dhe meqenëse Tekiu ishte duke u përcjellë me masa të fshehta, bisedën rreth pjesëve të veturës e ka interpretuar se i mbrojturi i tij ka dashur të blejë armë. Dihet se interpretimi ekstensiv është i ndaluar në të drejtën penale, atëherë ka theksuar se aktakuza ndaj të mbrojturit të tij duhet të refuzohet si e pa bazuar nga gjykata në mungesë të asnjë prove të vetme bindëse.
- Është për tu habitur se si prokurori ka akuzuar të mbrojturin e tij kur nuk ka të bëjë asgjë me këtë vepër penale, gjatë kontrollit në shtëpinë e tij nuk është gjetur asgjë e dyshimtë, ndaj tij nuk është bërë asnjë kërkesë për caktimin e ndonjë mase të sigurisë, pra asnjë fakt nuk ka dërguar drejt ngritjes së aktakuzës. Me rastin e pranimit të konfirmimit se i mbrojturi i tij është akuzuar, ka theksuar se ka shkuar dhe ka marrë të gjithë materialin e nevojshëm për mbrojtjen e tij, ka analizuar të gjitha materialet, kurse i mbrojturi i tij siç ka theksuar ceket vetëm në gjashtë

rreshta, pra nga ky material është e pakuptueshme se si ka ardhur deri te aktakuza ndaj të mbrojturit të tij, andaj në fund ka theksuar se asnjë nga pretendimet e prokurorit të shtetit nuk është vërtetuar se i mbrojturi i tij ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet për këtë ka kërkuar nga gjykata që ndaj të mbrojturit të tij të marr aktgjykim lirues.

I akuzuari **B.U.**, respektivisht mbrojtësi i tij, Avokat L. H. në fjalën përfundimtare ka theksuar:

- Edhe pas zhvillimit të kësaj procedure gjyqësore nuk është vërtetuar me provat e administruara se i mbrojturi im ka kryer veprën penale që i vihet në barrë e aq më pak sipas përshkrimit si në aktakuzë, kjo për faktin se sipas gjendjes faktike në aktakuzë thuhet se “nga periudha e panjohur kohore në vazhdimësi e deri me datën 29.09.2020 respektivisht 14.04.2021 ...”, prokurori i shtetit duke u bazuar në këtë periudhë kohore nuk ka saktësuar të njëjtën duke treguar se në cilën periudhë është ndërmarrë ndonjë veprim inkriminues nga ana e të mbrojturit të tij B.U. Kësisoj me asnjë provë prokuroria nuk ka mbështetur dyshimin e bazuar se i mbrojturi i tij të ketë ndërmarrë ndonjë veprim inkriminues gjatë periudhës së lartcekur.
- Këtë e argumenton edhe Procesverbali mbi kontrollin e banesës dhe personave i datës 29.09.2020, sipas të cilit rezulton se nuk është gjetur asnjë mjet (armë) në shtëpinë e të mbrojturit të tij B.U. Më tej akuza thotë se “duke vepruar sipas marrëveshjes paraprake...”. Kjo marrëveshje nuk është argumentuar me asnjë provë të vetme në raport me të mbrojturin e tij B.U. Kjo për faktin se nga shkresat e lëndës rezulton se i mbrojturi i tij vetëm ka komunikuar me bashkëfshatarin e tij në lidhje me një veturë (xhip) për shitblerje të saj dhe assesi nuk ka pasur ndonjë marrëveshje që do të e implikonte atë në ndonjë veprim të dyshimit kriminal.
- Në aktakuzën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovë thuhet se “kanë transportuar, ndërmjetësuar dhe shitur armë të llojeve të ndryshme në mënyrë të paautorizuar”. Sa i përket përshkrimit të këtyre veprimeve fillimisht duhet thënë se të njëjtat janë vetëm të parafrazuara sipas Kodit Penal dhe se me asnjë provë prokuroria nuk ka arsyetuar dyshimin e bazuar mirë se i mbrojturi i tij ka transportuar, ndërmjetësuar dhe shitur armë. Për më tepër në lidhje me transportin mund të themi se as në veturë dhe as në shtëpi të mbrojturit të tij, nuk është gjetur asnjë armë e cila ishte duke u transportuar në një vend të caktuar. Kurse sa i përket ndërmjetësimit dhe shitjes, i mbrojturi i tij nuk ka komunikuar dhe as që ka ndërmarr ndonjë veprim në lidhje me këto veprime. Nga provat materiale të bashkangjitura shkresave të lëndës rezulton se i njëjti ka komunikuar me B.M.,

vetëm për një veturë referuar si xhip dhe për gjendjen e tij, por në asnjë moment nuk është ndërmarrë ndonjë veprim që do të quhej i kundërligjshëm.

- Pra, në asnjë rast të vetëm, me asnjë provë të vetme nuk është vërtetuar përshkrimi i veprimeve inkriminuese të të mbrojturit të tij se kinse ai e ka ndërmarr ndonjë veprim me të cilin ka konsumuar veprën penale e cila i është vënë në barrë. Edhe përkundër mundësisë që aktakuzën ta modifikojë, hedhë apo tërheqë, prokurori i rastit ka mbajtur të njëjtin përshkrim faktik e të cilin deri më tani nuk ka mundur me asnjë provë ta mbështesë. Nën këto rrethana ka kërkuar nga gjykata që nën këto mangësi procedurale të ndërtimit të aktakuzës gjegjëse dhe pas konstatimit që vepra penale sipas përshkrimit faktik dhe sipas kualifikimit ligjor në këtë aktakuzë nuk është mbështetur në prova materiale por në dubioza e të cilat ka theksuar se pret nga gjykata që pas analizimit të këtyre rrethanave të paqarta t'i trajtojë sipas parimit "in dubio pro reo".

I akuzuari **S.K.**, respektivisht mbrojtësja e tij, Avokate L. K.-G. në fjalën përfundimtare ka theksuar:

- Nga fillimi i procedurës penale kjo çështje penale është paragjykuar dhe kjo ka ndodh për faktin se prokuroria ka hyrë në një situatë që dihet mirëfilli se nuk na shpie drejtë të vërtetës materiale,, nuk ka pasur prova materiale që e vërteton apo arsyeton dispozitivin e aktakuzës lidhur me të mbrojturin e saj, ku i njëjti nuk ka të kaluar kriminale, nuk është ndeshur kurrë me ligjin, arma e cila është gjetur në shtëpinë e tij ka qenë e babait të tij tani të vdekur për të cilën kanë edhe leje dhe i njëjti nuk e ka ditur se duhet bërë kërkesë për vazhdimin e lejes. Poashtu ka theksuar se për të mbrojturin e saj është dashur të veçohet lënda dhe të dërgohet në departamentin tjetër meqë Departamenti Special është absurde të merret me veprën penale të armëmbajtjes pa leje.
- I mbrojturi i saj me përgjegjësi të plotë deklaroi se asnjëherë nuk ka përdorur armë dhe as nuk ka pasur armë personale, e as armë për gjueti pasi që nuk është preferues i armëve, e as nuk do të merrte leje për armë. Nga kjo që është paraqitur pa mëdyshje del fakti se dyshimi i bazuar nuk e kalon pragun e arsyeshmërisë e veçmas ngase nga provat që gjenden në shkresat e lëndës nuk ka elemente të kësaj vepre penale për të cilën akuzohet i mbrojturi i saj dhe se dyshimi i bazuar mirë nënkupton ngritjen e aktakuzës, andaj nga këto arsye ka konsideruar dhe ende konsideron se në rastin e të akuzuarit S.K. nuk ka asnjë veprim të kundërligjshëm dhe se prokuroria nuk ka ofruar asnjë provë relevante për vërtetimin e ekzistimit të veprës penale e cila i vihet në barrë të njëjtit.

Gjetjet e gjykatës në raport me aktgjykimin:

Gjykata në raport me këtë çështje penale dhe aktin akuzues të parashtruar në këtë çështje penale, do të shtjelloj: vërtetimin e gjendjes faktike në këtë çështje penale e për të cilën të akuzuarit janë shpallur fajtor; provat e faktet të cilat kanë sjellë deri tek gjetja fajtor e të akuzuarve; pretendimet e mbrojtjes për çështjet e caktuara të parashtruara në fjalë përfundimtare; vendimin mbi dënimin, konfiskimin dhe shpenzimet procedurale.

Fajësia e të akuzuarve në raport me gjendjen faktike:

Nga provat e administruara në këtë shqyrtim gjyqësor si:

- Vërtetimet mbi marrjen e sendeve të datës 29.09.2020 dhe 14.04.2021;
- Fotografitë dhe SMS të marra nga pajisjet e të akuzuarve;
- Raportet e përgjimeve dhe të bisedave telefonike dhe SMS;
- Raportet e vëzhgimit të të akuzuarve;
- Raportet e ekzaminimit të armëve të datave: 21.01.2021 dhe 28.04.2021;
- Raporti i ekzaminimit të parave i datës 14.01.2022;
- Raportet e ekzaminimit të telefonave të datave: 13.12.2021 dhe 18.01.2022;
- Foto-dokumentacioni në shkresat e lëndës lidhur me rastin dhe të akuzuarit;

Provat e lartë-theksuara, respektivisht pas administrimit të këtyre provave, gjykata të akuzuarit i ka gjetur e shpallur fajtor, për veprat penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa në pjesën në vazhdim do të shtjellohen veprimet e të akuzuarve në drejtim të kryerjes së veprës-veprave penale, për të cilat janë shpallur fajtor.

Të akuzuarit: S.R., I.R., B.M. dhe B.U.

Gjykata këta të akuzuar i ka shpallur fajtor për veprën penale në bashkëkryerje dhe vazhdimësi importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve nga neni 364 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 lidhur me nenin 31 të KPRK si dhe e akuzuara I.R. edhe për veprën penale falsifikimi i parasë nga neni 296 paragrafi 2 të KPRK.

Këta të akuzuar janë gjetur fajtor se nga periudha e panjohur kohore në vazhdimësi e deri me datën 29.09.2020, respektivisht deri me datën 14.04.2021, duke vepruar sipas marrëveshjes paraprake e me qëllim të furnizimit, transportimit, këmbimit, ndërmjetësimit e shitjes së paautorizuar të armëve, kanë transportuar, ndërmjetësuar dhe shitur armë të llojeve të ndryshme në mënyrë të paautorizuar me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore të kundërligjshme.

Gjykata si fakte të pa-mohueshme në këtë çështje penale gjatë shqyrtimit gjyqësor në raport me këta të akuzuar ka vërtetuar se:

Të akuzuarit I. e S.R., furnizimin me armë e municione, kryesisht e kanë bërë nga shtetet përreth, pasi që nga raportet e vëzhgimit shihet se kanë pasur lëvizje të shpeshta në Pikën kufitare në "B." me veturën e tyre "VW ..." me ngjyrë vishnje me targa ...

Nga raporti i vëzhgimit që përfshinë periudhën 15.01.2020 deri me datën 14.02.2020, kjo gjykatë ka vërtetuar se të akuzuarit I. e S.R. me datë 11.02.2020, kanë shkuar në P. për furnizim me armë dhe municione tek familja K. në P., mirëpo të njëjtit atë ditë nuk kanë arritur t'i marrin armët por të nesërmen S., ka marrë një veturë me qira dhe përsëri, kanë shkuar në P., tek persona të cilët merren me shitblerje të armëve.

Nga raporti i vëzhgimit i datës 15.02.2020, kjo gjykatë ka vërtetuar se i akuzuari S.R. është takuar me një person i cili ka ardhur nga S., ku së bashku me të dhe dy persona tjerë takohen në kafenenë "V." dhe pastaj S. së bashku me tre personat hyjnë në veturën "G." duke shkuar në drejtim të fshatit "G." dhe pastaj në P., ku S. së bashku me njërin prej personave hyjnë në një shtëpi në bazë të këtij raporti, ku gjykata ka vërtetuar se qëllimi dhe takimi i të akuzuarit S. me persona të ardhur nga S. dhe të gjitha lëvizjet janë bërë me qëllim të shitblerjes së armëve.

Nga raportet e përgjimeve për të akuzuarit I. dhe S.R., kjo gjykatë ka vërtetuar se të njëjtit nga numrat e tyre të telefonave 044... (S.R.) si dhe nga numri 045... (I.R.) të njëjtit, kanë pasur kontakte dhe biseda me persona të ndryshëm e krejt kjo me qëllim të shitblerjes së armëve si dhe me të akuzuarit B.M. e B.U. të cilët edhe i kanë furnizuar me armë e municione, ku herë pas here edhe me të akuzuarit tjerë si A.F., F.P., K.S., A. S., B.H. dhe S.K..

Në komunikimet e tyre të datës 24.01.2020 në ora 21:19:46, S.R. i thotë S.K. "*ta shkruva ni mesazh, thash me ardhë deri ktu, ta kom pru diçka çka ke lypë*", ndërsa S.K. ia kthen përgjigjen "*shumë a*", S.R. i përgjigjet "*sa dush, me traktor me ardh me i ngarku*", S.K. prapë ia kthen përgjigjen "*ti kur ish vakti s'mi bike, kur me lypshin qa i*

duhen ata". Nga kjo bisedë telefonike vërtetohet se i akuzuari S.R. e njofton S. K., që mundet të shkoj e t'i merr armët dhe nga biseda ku thuhet me *"traktor me i ngarku"*, shihet se bëhet fjalë për shitblerje të municionit. Po ashtu nga ky komunikim i këtyre të akuzuarve për shitblerjen e armëve, konsiston edhe në faktin se këta të akuzuar e kanë njohur njëri tjetrin dhe se nuk është fakt i qëndrueshëm konstatimi e pretendimi i disa prej mbrojtësve e të akuzuarve, se ata nuk janë njohur ndërmjet vehte. Kjo bisedë tregon se këta dy të akuzuar jo vetëm se e kanë njohur njëri tjetrin, por edhe kanë komunikuar për shitjen e blerjen e armatimit, që nënkupton se: janë njohur ndërmjet vehte; kanë bashkëpunuar; janë furnizuar me armatim paraprakisht; janë dakorduar paraprakisht për furnizim me armatim; më pastaj edhe i kanë blerë e i kanë shitur njëri tjetrit.

Në komunikimet e datës 05.02.2020 në ora 15:27:13, S.R. dhe F.P., bisedojnë në gjuhën boshnjake dhe ndër të tjera S. i thotë F. *"e kam një shok, që po don me ardhë me këqyr diçka"*, F. P. ia kthen përgjigjen *"a është i njëjti"*, S.R. i përgjigjet *"jo një tjetër është, i kam tregu atë ditë që isha në P. edhe tash po me pyet a mundem me pa, i thash se di, duhet me pyet unë edhe të tregoj"*, F. P. ia kthen përgjigjen *"kerrin se kam ketu e nese, po nese t'i mundesh eja merre edhe le ta shikon ai"*, S. R. i përgjigjet: *"ai më ka thanë që me ardhë me pa vet"*, F.P. ia kthen përgjigjen *"jo këtu s'mundet me ardhë ai e me ia tregu unë, nëse don me ardhë hajde merre edhe ia tregon"*, S. *"ok qe tash po vi unë e marrë edhe ia tregoj"*.

I.R. nga numri i saj i telefonit 045..., telekomunikon me numrin 044... që përdor i akuzuari K.S., ku me datën 24.01.2020 në ora 20:00:14 në këtë bisedë I.R. i thotë K. e K. i përgjigjet *"sot jam larg dhe pyet kur vijnë ata"*, I. R. i thotë *"po ka ardh vetëm me ka than deri nesër parat në dorë"*, K. i përgjigjet *"nesër vij andej"*. Me datën 03.02.2020 në ora 18:19:17 në këtë bisedë ndërmjet I.R. e K.S., I. kontakton K. duke i thënë *"eja deri te unë se ke diçka për të parë ndeshtë me blerë ndokush nga ju"*.

Nga komunikimet e më tejme ndërmjet të akuzuarve I.R. dhe K.S., me datë 07.02.2020 në ora 13:00:14 e 19:11:11, bisedat ndërlihdën mes vete, ku K.S. e kontakton I.R., duke i thënë *"thuaj atij për 430 parat në dorë"*, I. i përgjigjet *"i kam than po nuk po e jep dhe ka than deri nesër vij e marr"*, K. i prap i thotë *"kryhet qashtu unë pa fitim me kanë si me qeros 20 euro bile aj qeni"*.

Me datën 10.02.2020 në ora 10:51:23 në këtë bisedë K.S. e kontakton I.R., pasi që I. nuk e hap telefonin, ku në sfond dëgjohet K.S., duke diskutuar me një person tjetër për një pistoletë, ku ky person i thotë K.S. *"për dyqind e tridhjetë apo dyqind e dyzet Euro, mos e jep alltinë"*, K. i përgjigjet *"dyqind e pesëdhjetë me dhjetë fishekë"*, personi tjetër i thotë *"dyqind e dyzet me dhjete fishekë"*.

E akuzuara I.R. nga komunikimet të cilat i ka bërë e duke përfshirë edhe komunikime të evidentuara në raport e përgjimit, është edhe komunikimi nga numri i saj 045... ku

telekomunikon me numrin 049..., që përdoret nga B.H.. Me datën 10.02.2020 në ora 19:24:04 në këtë komunikim B.H. i thotë I.R. *“po vij pe marr atë pas një ore ti bij para”*, I. i përgjigjet *“nuk mundem ashtu zdi qa te bej”*, B.H. i thotë *“nëse donë ti bij dokumentet e veturës dhe qfar ti dëshiron për një ore”*, I.R. i përgjigjet *“ashtu bën por për momentin nuk jam ne shtëpi”* dhe mbetet më vonë të shkoj B. te I.

Gjatë shqyrtimit gjqësor, por edhe me asnjë provë si të administruar nga gjykata, por edhe të propozuar nga të akuzuarit, nuk është vërtetuar se ky komunikim i I.R. dhe B. H., ka të bëjë me blerjen e ndonjë veture, por si u theksua në asnjë moment edhe të akuzuarit nuk kanë dëshmuar se me çfarë veture ka të bëjë ky komunikim dhe se cilat dokumenta është dashur të dorëzohen. Pra, në rastin konkret kemi të bëjmë me komunikime të cilat lidhen me shitjen e blerjen e armëve ndërmjet të akuzuarve I.R. e B.H.

Në vazhdim të këtij arsytimi të aktgjykimit sa i përket të akuzuarës I.R., do të shtjellohen edhe komunikime tjera e ekzaminime të pajisjeve, ku nga këto komunikime është edhe komunikimi nga numri i saj 045..., ku telekomunikon me numrin 044... që përdor F. R., bashkëshortja e të akuzuarit S.R.. Me datën 11.02.2020 në ora 09:42:53 e 12:15:52, bisedat ndërlidhën ndërmjet të akuzuarve dhe kanë të bëjnë me B. H., ku I.R. i thotë F. se *“nëse vjen B. thuaj nuk është këtu por kemi shkuar me marr”*. Që nga kjo bisedë, shihet qartë se e akuzuara I. R., ka shkuar për ta siguruar (marrë) armën dhe për t’ia sjellë B. H., ku e porositë gruan e djalit të saj se nëse thërret B.H., t’ia përcjell porosinë se ka shkuar për ta marrë armën dhe që të pret.

Nga tërësia e këtyre përgjimeve të telekomunikimeve shihet qartë dhe vërtetohet se të akuzuarit kanë komunikuar për shitblerjen e armëve, por gjatë tërë kohës duke u kujdesur që mos të përmenden emra të armëve, apo municioneve. Nga këto përgjime, gjykata ka vërtetuar se të akuzuarit tjerë furnizimin kryesisht e kanë bërë tek të akuzuarit S.R. dhe I.R. të cilët janë furnizuar nga persona të tjerë dhe këto armë ia kanë shitur bashkë të akuzuarve, e të cilët më pastaj i kanë shitur tek të tjerët apo tek njëri tjetri të akuzuar në këtë çështje penale.

Përpos komunikimeve të cialt i kanë pasur të akuzuarit I.R. e S.R. me të akuzuarit e tjerë dhe atë duke u dakorduar për shitjen e blerjen e armëve, ekzaminimi i paisjeve elektronike, respektivisht në ekzaminimin e “Samsung Note 3” të të akuzuarës I.R., janë gjendur edhe fotografi të armëve të cilat i ka fotografuar për t’iu treguar të akuzuarve tjerë të cilët i kanë blerë këto armë dhe atë foto të armëve të ndryshme, si revole, etj.

Gjykata të akuzuarën I.R., përpos veprës penale e cila ka të bëjë me armë, e ka gjetur e shpallur fajtor edhe për veprën penale falsifikimi i parasë nga neni 296 paragrafi 2 të KPRK.

Kjo e akuzuar është shpallur fajtores se nga data e pavërtetuar e deri me datën 29.09.2020, ka pranuar e poseduar para të falsifikuara, ashtu që gjatë kontrollit të shtëpisë së saj në fshatin ... të Komunës së I., nga ana e policisë i është gjetur e konfiskuar një kartëmonedhë prej 100 (njëqind) Euro me numër serik ... e cila pas ekzaminimit ka rezultuar të jetë e falsifikuar. Se e akuzuara ka kryer këtë vepër penale, vërtetohet nga raporti i ekspertimit i datës 14.01.2022 nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë, ku pas ekzaminimit të banknotës prej 100 Euro me numër serik ..., ka gjetur se *“në bazë të rezultatit për ekspertim konstatohet se kartëmonedha në dëshminë #1 është falsifikim i plotë”*.

Pra, është fakt i pakontestueshëm se banknota e falsifikuar është gjetur në shtëpinë e të akuzuarës I.R., respektivisht është gjetur tek e akuzuara I.R., por në asnjë moment nuk është vërtetuar e kundërta si nga provat e administruara nga gjykata e as e akuzuara apo mbrojtja e saj të jetë propozuar apo prezantuar ndonjë provë e cila do ta vërtetonte se e akuzuara nuk e ka poseduar apo nuk e ka ditur se paraja është e falsifikuar. Andaj, gjykata bazuar në faktin e ekspertimit të treguar se bankënota është e falsifikuar dhe se është gjetur tek e akuzuara I.R., ka gjetur se në veprimet e të akuzuarës pamëdyshje përmbushen elementet e veprës penale të falsifikimit të parasë, ashtu si dhe është shpallur fajtor e dënuar me këtë aktgjykim.

Përpos telekomunikimeve, ekzaminimit të pajisjeve dhe provave të siguruara me masa të fshehta, tek të akuzuarit I.R. e S.R., gjatë kontrollit në shtëpinë e tyre është gjetur: një sasi e armëve; kartmonedha e falsifikuar; telefon të përdorur në vepër penale dhe automjeti i cili është përdorur në vepër penale. Këto të dëshmuara me vërtetimin mbi marrjen e sendeve, ku gjatë kontrollit të shtëpisë së tyre me vërtetimin mbi marrjen e përkohshëm të sendeve të datës 29.09.2020, janë marrë: 1 telefon celular “ZTE” me ngjyrë të bardhë numër serik 863355030795235-863355030863231; 1 telefon celular “Nokia” numër serik 357270/05/240716/8-257270/05/240717/6; 1 telefon celular “Samsung” me numër të telefonit 049...; 1x100 (njëqind) Euro e cila ka rezultuar e falsifikuar; 5 pistoleta “Zoraki” me mbishkrim “Sig Sauer-P3657.65” pa numër serik si dhe një veturë e tipit “WV Vento” me numër të targave ... e cila është përdorur fillimisht në transportimin e furnizimin me armë e mëpastaj edhe në transportimin e armëve me qëllim shitjeje tek të akuzuarit e tjerë në këtë çështje penale.

Gjykata me rastin e vendosjes mbi fajësinë e të akuzuarve, respektivisht gjetjen e tyre fajtor, ka administruar një sërë provash e të cilat janë siguruar përmes rrugës hetimore e masave të fshehta hetimore të zbatuara në këtë çështje penale. Po ashtu ka administruar edhe provat e rezultuara nga ekzaminimi i pajisjeve të komunikimit të të akuzuarve, ku nga këto pajisje rezulton se të njëjtët kanë pasur komunikime të shpeshta ndërmjet vehte në raport me sigurimin e armëve e mëpastaj edhe për shitjen e tyre.

Gjykata, nga përmbajtja e “SMS” të komunikimit, fotografive të siguruara në këtë çështje penale gjatë fazës hetimore, bisedave telefonike e raporteve të vëzhgimit nga

organet e ndjekjes penale, ka gjetur se i akuzuari B.M., ka pasur lëvizje, thirrje e kontakte të shumta me qëllim të blerjes e shitjes së armëve e municioneve, ku kryesisht furnizimin e ka bërë tek të akuzuarit I.R. e S.R. të cilët në atë kohë kanë jetuar e po ashtu edhe vepruar në fshatin ... të Komunës së I. Po, ky i akuzuari (B.M.), përpos që është furnizuar tek këta dy të akuzuar, furnizimin e tij me armë e municione e ka bërë edhe tek i akuzuari B. U.

Gjykata në raport me të akuzuarin B.M., ka administruar raportin e ekzaminimit të pajisjeve elektronike të marrura nga i njëjti dhe atë nga ekzaminimi i telefonit të tij (Iphone 6) dhe komunikimeve me “SMS” e me platformat digjitale “Facebook” e “WhatsApp”, respektivisht nga administrimi i raportit të datës 13.12.202 ka rezultuar se i akuzuari B.M., ka biseduar me persona të ndryshëm për shitblerjen e armëve, municionit e rreth çmimit të tyre, ku gjatë analizimit të këtyre bisedave janë veçuar ato si:

Biseda në “Facebook” me personin I. M. e H. R., ku në pamundësi që nga ky rrjet social të nxirren të dhëna rreth këtyre personave, janë nxjerrë vetëm emrat dhe mbiemrat e këtyre personave, po ashtu në “WhatsApp”, është vërtetuar se i njëjti ka biseduar me personat A. Sh., A. J., B. Sh. dhe me personin me emrin A. Të gjitha këto biseda janë bërë me qëllim të furnizimit, blerjes e shitjes së armëve.

Nga raporti i vëzhgimit në vende publike (vëzhgim me video e fotografi si pjesë e implementimit të masave të fshehta hetimore) për periudhën kohore 05.12.2019 deri 04.02.2020, është vërtetuar se B.M., gjatë kësaj periudhe ka pasur takime me persona të ndryshëm me qëllim të shitblerjes së armëve. Me datë 10.01.2020, i njëjti gjithashtu është takuar edhe me të akuzuarin S.R., ku po ashtu edhe nga ky takim shihet se të njëjtit janë takuar me qëllim të shitblerjes së armëve, fakt të cilin e dëshmon raporti i vëzhgimit.

B.M. i shpallur fajtor për veprën penale iskurse në këtë aktgjykim, se është furnizuar me armë tek S.R. e I.R., vërtetohet edhe nga një bisedë e zhvilluar në mes të B.M. dhe I.R., bisedë e datës 08.01.2020. Në këtë bisedë B.M. e njofton I.R., duke i thënë se *“atë e kam hequr dhe paret ti bij më vonë”* dhe që të dy dakordohen që B. t’ia dërgojë paratë më vonë, diku rreth orës 18:00, ku nga kjo bisedë pa mëdyshje vërtetohet se bëhet fjalë për armën të cilën B. e ka shitur dhe se paratë për shitjen e armës do t’ia dërgojë më vonë I.R.

B.M., është vërtetuar se e ka poseduar edhe numrin e telefonit 044... dhe se gjatë aplikimit të masave të fshehta për këtë numër, është vërtetuar se ka pasur biseda të ndryshme me persona të ndryshëm për shitjen e armëve, por po ashtu ka pasur edhe biseda me të akuzuarit I.R. e S.R., nga të cilët është furnizuar me armatim.

Nga raporti i përgjimeve për periudhën kohore prej datës 06.12.2019 deri më datë 23.12.2019, gjykatë ka vërtetuar se i akuzuari B.M., lidhur me shitblerjen e armëve ka bashkëpunuar ngushtë me të akuzuarit S.R. dhe të akuzuarin B.U., ku i njëjti furnizohej me armë tek S.R. e më pas i akuzuari B.U. i ka shitur tek persona tjerë.

B.M. nga numri i tij telefonit, komunikon me numrin i cili është në përdorim të S.R.. Me datën 27.01.2020 në ora 12:21:33, ku në këtë bisedë B. M. e kontakton S.R., duke i thënë *“a ke këqyr për qatë”*, S. i përgjigjet *“nuk kam mundur me ren ne kontakt me atë veç këqyri tash edhe pak”*, B. i thotë *“ani me kanë vetëm një po donë me e këqyr, ose takohemi bashkë këqyr”*, S. i përgjigjet *“u krye se aj nuk është kesajde, po këqyri unë po flas nëse mundem me ra ne kontakt e tani dëgjohemi”*. Ku nga kjo pjesë e bisedës-komunikimit, duke marrë në konsideratë edhe komunikimet tjera të ndodhura ndërmjet këtyre të akuzuarve, vërtetohet pamëdyshje se të njëjtit kanë komunikuar për shitje të armëve, e ku B.M. është furnizuar nga S.R. e I.R. dhe këto armë i ka shitur personave të tjerë, ku fillimisht ua kanë ekspozuar armët se a i dëshirojnë këto armë e më pastaj edhe shitur të njëjtat.

I akuzuari B.M., po ashtu nga numri i tij i telefonit komunikon me numrin që përdor I.R.. Me datën 08.01.2020 në ora 13:23:45 në këtë bisedë telefonike, I. e kontakton B. duke i thënë *“paret mos ja jep S.”*, B. i përgjigjet *“ndoshta pe hiqi edhe te thirri tani”*. Me datën 13.01.2020 në ora 18:37:56, përsëri ka pasur komunikime ndërmjet këtyre të akuzuarve dhe atë në këtë bisedë, B. e pyet I. *“qa po bën”*, I. i përgjigjet *“asgjë qetu në shtëpi”*, B. i thotë *“dil deri përjashta, qetu jam ne oborr te ti”*.

Ku nga këto komunikime të të akuzuarit B.M. me të akuzuarën I. A., shihet se këta të akuzuar e kanë njohur njëri tjetrin, kanë bashkëpunuar dhe se kanë bërë furnizim, shitje e blerje të armëve, e që e faktin edhe biseda për çështjen e çmimit të dakorduar për armë, ku i thotë e akuzuara I.R. që mjetet apo paratë e shitjes së armëve të mos ia jep S.R., dajlit të saj, por t’ia jep asaj, ndërsa ai në komunikimin e më vonshëm e njofton se është në oborrin e shtëpisë së saj dhe të del ta takoj për t’i marrë parat. Ndërsa nga raporti i përgjimeve për periudhën kohore 24.12.2019 deri me datën 07.01.2020, është vërtetuar pa mëdyshje se bisedat e zhvilluara kanë të bëjnë me shitblerje të armëve dhe kanë lidhmëri me njëra tjetrën, i akuzuari B.M. gjatë bisedave telefonike ka qenë i kujdesshëm që të mos përmend armë në telefon dhe ka përdorur kode të ndryshme siç janë *“e vogla e zezë”* ku e ka fjalën për revole, apo *“adaptera të telefonit”* që ka të bëjë me armë e municion të armëve.

Gjykata, nga vërtetimi mbi marrjen e përkohshme të sendeve i datës 29.09.2020, ka vërtetuar se gjatë kontrollit në shtëpinë e të akuzuarit B.M., janë gjetur e sekuestruar:

një telefon celular “Iphone 6” me numër të IMEI ...; një veturë “VW...” me targa ... si dhe një librezë e kësaj veture. Tek ky i akuzuar, këto sende janë sekuestruar e konfiskuar për faktin se janë përdorur në kryerjen e veprës penale dhe atë vetura është përdorur në transport të armëve e në lëvizjet e të akuzuarit për të bërë shitjen e blerjen e armëve, ndërsa me telefonin celular ka komunikuar për shitjen e blerjen e armëve, si me të akuzuarit e tjerë të kësaj çështjeje penale e po ashtu edhe me persona tjerë të cilëve iu kanë shitur armë.

I akuzuari B.U., i njëjti gjithashtu ka pasur biseda e takime të shpeshta me të akuzuarin B.M., ku të gjitha bisedat i kanë lidhur me shitblerje të armëve e municioneve, ku në disa përgjime përmenden emra të armëve dhe municioneve. Pra, ky i akuzuar nga këto komunikime vërtetohet qartë se ka blerë e shitur armë dhe se ka qenë në kontakt e bashkëpunim të vazhdueshëm me të akuzuarin B.M., i cili furnizohej me armë e municione nga të akuzuarit I.R. e S.R.

Me datë 12.12.2019 në ora 12:09:37, i akuzuari B.M., thërret të akuzuarin B.U. dhe në bisedë e sipër, B. e pyet B. se *“a ke bo najsën për atë sharrën e vogël, zinxhir a ki”*, B. i përgjigjet *“po more gjojm, mujm mi gjet”*, B. e pyet prapë *“sa po bojn a po din gjo”*, B. përgjigjet *“ka njo”*, B. e pyet B. *“ni dhom ni euro a”*, B. i përgjigjet *“po, a e don komplet a qysh”*, B. i përgjigjet: *“jo jo komplet, per dy sharra, dy parë zinxhir, ani sa pi bjen”*, B. i përgjigjet *“vallahi kanë tjetër çmim B., veç për ty 2 e 80 kisha mujt ty me t’i dhanë, që me nxjerr edhe t’i najsën”*.

Nga kjo bisedë e B.M. me B.U., shihet qartë se ka të bëjë me blerjen e municionit të armëve dhe nuk ka të bëjë asgjë me sharrë, pasi që njëherë pyet për sharrë, pastaj përdor termin zingjir për mbulesë për fishekë dhe në fund e pyet se një *“dhëmb-dhom”* ka kushton që nuk ka të bëjë asgjë me dhëmb e as me zingjir por ka të bëjë me municion të cilin e siguron. Ku kjo pjesë e komunikimit është në kundërshtim me çdo pretendim të këtij të akuzuari dhe mbrojtjes së tij, pasi që nuk ka të bëjë me pyetjen për ndonjë sharrë për ta blerë apo zingjir sharre, por për municion e të cilin municion ta blej me çmimin prej 2.80 Euro, por që B.M., B.U., t’ia mundësoj të përfitoj nga shitja e tij, ku edhe e konfirmon duke i thënë se *“... 2 e 80 kisha mujt ty me t’i dhanë, që me nxjerr edhe t’i najsën”*.

Në po të njëjtën bisedë, pas disa komunikimeve ndërmjet vete B. i thotë B. *“ani veç zinxhirt se sharrën e kam”*, B. ia kthen përgjigjen *“a po a, a shum”*, B. i përgjigjet *“po 100 copa, 100 dham”*. Në bazë të bisedës së zhvilluar është vërtetuar se të njëjtit gjatë tërë kohës kanë biseduar për municion dhe për 100 fishekë. Pasi që me asnjë provë e as nga ato të administruara nga gjykata, nuk ka mundur të vërtetohet se ka të

bëjë me sharrë e as me zingjir sharre, por këto shprehje janë përdorur si kamuflim i blerjes së municionit dhe atë të 100 copë fishekëve të armës për çmimin e caktuar.

Komunikimet e të akuzuarve B. M. e B.U., nuk përfundojnë vetëm me këto biseda të theksuara deri më tani, por me datë 31.12.2019 në ora 15:53:25, B.M., bisedon me B.U. dhe në bisedën e tyre, B. i thotë B. *“ai ke e marr qitash ato, tha pse qashtu qaj, thash une t'kallxova ka jemi shku në kerr se qita s'bajn, thash provo sonte, tha e provoj dy-tri copa, thash jo po mushe dhe provo e mos um thirr tani mo”*, pastaj edhe B. ia kthen *“ani mirë boll edhe unë knej e krevë”*. Nga kjo bisedë, gjykata ka vërtetuar se bëhet fjalë për shitblerje të armës, në fakt të municionit për armë, ku B.U. e njofton B.M., se municioni i marrur nga ai nuk i funksionon në armë, ai e njofton B. se personit të cilit ia ka shitur t'i ketë thënë se provoje municionin, mbushe e provoje dhe më që të mos e thirrë për këtë çështje, e ku B. i përgjigjet B. se edhe ai e ka përfunduar punën e tij *“ani mirë boll edhe unë knej e krevë”*.

Me datë 03.01.2020 në ora 11:54.04, B.M., përsëri bisedon me B.U. dhe B. e pyet B., lidhur me një mjet që i referohen si “xhip”, por në bazë të bisedave vërtetohet se bisedojnë për një armë të cilën B., interesohet që ta blej nga një person i tretë, duke ndërmjetësuar me B., në mënyrë që të njëjtën ta shes tek personi i katër me vlerë prej 700-800 Euro. Po ashtu me datë 21.01.2020 në ora 14:01:31, personi i panjohur (që duket se është familjar i B.U.) e thërret B.U. dhe në bisedë i thotë B. *“hej qaje tu bo, veç e qon jogun, qaty i kom lan ato shrafcigerat, nër jog braqni”*, pastaj B. ia kthen *“n'sob tane a”* personi i panjohur i përgjigjet *“po qaty janë ai kompleti me shrafcigera”*.

Nga këto biseda telefonike ndërmjet B.M. e B.U., konstatohet se i gjithë komunikimi është bërë për blerje të armëve dhe municionit, e jo për çështje tjera. Kur merren në kosnideratë komunikimet e të akuzuarit B.M. me të akuzuarit S.R. e I.R., nga të cilët është furnizuar me armë, shihet qartë se B.U., është furnizuar me armatim nga B.M. dhe ia ka shitur personave tjerë këto armë e municion, sikurse ka biseduar edhe për municionin për t'ia shitur personit të tretë e të cilat nuk i kanë funksionuar dhe t'i ketë thënë provojsi e mos më thirr më, e jo se të ketë pasur të bëjë me sharrë e as zingjir sharre.

Të akuzuarit: A.F., A.C., P.M., S.K., F.P., K.S. dhe B.H.

Këta të akuzuar janë gjetur fajtor se nga periudha e panjohur kohore në vazhdimësi e deri me datën 29.09.2020, respektivisht deri me datën 14.04.2021, duke qenë në dijeni që të pandehurit S.R., I.R. e B.M., merren me shitblerjen e armëve, ku të interesuar për blerjen e tyre e më pas dhe shitjen, kanë komunikuar fillimisht përmes telefonit me ta duke u marrë u dakorduar për llojin e çmimin e armëve e të municionit, e pastaj janë

takuar në vende të ndryshme si: restorante, pompa të derivateve (më së shpeshti në shtëpitë e tyre) kanë transportuar, ndërmjetësuar dhe shitur armë të llojeve të ndryshme në mënyrë të paautorizuar, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore të kundërligjshme.

I akuzuari A.F., ka pasur biseda e takime të shpeshta me të akuzuarit B.M. e S.R., ku të gjitha bisedat i kanë në raport me shitblerjen e armëve dhe municioneve.

Nga raporti i ekzaminimit të pajisjeve elektronike (telefonëve të të akuzuarve) i datës 13.01.2021, rezulton që në telefonin e të akuzuarit A.F., janë gjetur fotografi të armëve si: pistoleta, AK-47 (Kallashnikov), municion dhe një video incizim me armë-revole në dorë, ku nga këto vërtetohet se ky i akuzuar ka bërë shitblerje të armëve dhe municioneve. Paraprakisht si u theksua se furnizimin me armë e municion i akuzuari A.F. e ka bërë nga B.M. e S.R., e të cilat armë i ka shitur pastaj personave tjerë të interesuar për blerjen e armëve.

I akuzuari A.F., se ka bërë furnizimin me armë nga S.R. e të njëjtat armë i ka shitur të tjerëve, dëshmojnë edhe armët e gjetura gjatë kontrollit të shtëpisë së të akuzuarit A.F. dhe atë nga vërtetimi për marrjen e sendeve si: 1 revole “Bereta” 9mm me numër serik A... (me leje të armës së shenjëtarisë me numër ...); 15 fishekë të kalibrit 9x19 mm me mbishkrim GFL; 1 karikator i zbrazët; 1 mbushës i karikatorit; 2 dorëza të revoles (pistoletës) si dhe pesë fishekë të kalibrit 9x19 mm.

I akuzuari A.C., po ashtu është gjetur fajtor për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor në këtë çështje penale. Ku i njëjti sikurse edhe të akuzuarit tjerë, kanë komunikuar ndërmejt vehte për shitjen e blerjen e armëve. I akuzuari A.C. nga numri i tij i telefonit 045..., ka pasur biseda e takime të shpeshta me të akuzuarin B.M., ku të gjitha bisedat i kanë në raport me shitblerjen e armëve e municioneve, ku në disa biseda edhe përmenden emra të armëve e kalibrave. Gjykata nga këto përgjime të telekomunikimeve të këtij të akuzuari me të akuzuarin B.M. dhe interesi i tij për furnizim, respektivisht të blerjes së armëve e municionit me qëllim për shitje, ka vërtetuar se ky i akuzuar është fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet.

Nga raporti i ekzaminimit të pajisjeve elektronike, respektivisht telefonave të të akuzuarve i datës 13.01.2021, respektivisht nga ekzaminimi i telefonit të akuzuarit A.C., rezulton që në telefonin e të akuzuarit, janë gjetur fotografi të një pistolete dhe një fotografi ku i akuzuari e ka në dorë një AK-47 (Automatik Kallashnikov 47).

Komunikime rreth blerjes dhe shitjes së armëve ka pasur edhe i akuzuari P.M., ku po ashtu ky i akuzuar ka shfrytëzuar të njëjtën linjë të furnizimit me armë dhe shitjes së tyre. I akuzuari P.M. në bashkëpunim me B.M., respektivisht përmes tij është furnizuar me armë e municione nga S.R. e I.R., ku të njëjtat armë të blera nga ta i ka poseduar e shitur. Nga telekomunikimet që ka pasur ky i akuzuar, ka pasur biseda e takime të shpeshta me të akuzuarin B.M., ku të gjitha bisedat i kanë në lidhje me shitblerjen e

armëve e municioneve, ku në disa biseda edhe përmenden emra të armëve e kalibrave të armëve.

Përfundimisht, nga këto komunikime, biseda e bashkëpunim i të akuzuarit P.M. me B.M., për funizim me armë nga të akuzuarit S.R. e I.R. dhe shitjen e tyre, vërtetohet se i akuzuari P.M. në veprimet e tija, ka konsumuar elementet e veprës penale të cilat i vihen në barrë e për të cilën edhe është shpallur fajtor. Këtë konstatim e mbështet edhe më shumë raporti i ekzaminimit të pajisjeve elektronike, respektivisht i telefonit të të akuzuarit P.M., raport i datës 13.01.2021, ku është konstatuar se në këtë pajisje janë gjetur fotografi të një pistolette në të cilën shihet P.M., duke mbajtur atë.

S.K., ky i akuzuar është gjetur po ashtu fajtor për veprën penale në raport me armë, respektivisht për veprën penale për të cilën është shpallur edhe fajtor. Po ashtu ky i akuzuar ka pasur biseda telefonike me të akuzuarin S.R., ku në këto biseda kanë biseduar e diskutuar për blerjen e armëve dhe atë për llojin e armëve, duke i përmendur me emra dhe blerjen e municioneve nga i akuzuari S.R.

Përpos komunikimeve në telefon, i akuzuari S.K., ka pasur edhe takime të shpeshta me të akuzuarin S.R., ku të gjitha bisedat i kanë pasur lidhur me shitblerjen e armëve e municioneve, ku në disa biseda përmenden emra të armëve dhe kalibrave të cilat kërkohen për blerje. Nga raporti i ekzaminimit të pajisjeve elektronike, telefonit të të akuzuarve tjerë, respektivisht ekzaminimi i telefonit të të akuzuarit S.K., ku në raportin e datës 13.12.2021, ka rezultuar se në telefonin e të akuzuarit S., shihet po ky i akuzuar duke gjuajtur me armë AK-47 (Kallashnikov 47) dhe atë këtë e pasqyron video me numër 20190918 e cila video është pjesë e shkresave të lëndës e vendosur në CD.

Se i akuzuari S.K., ka qenë i kyqur në blerjen e shitjen e armatimit me të akuzuarit e tjerë e vërteton edhe fakti i kontrollit të shtëpisë së tij, ku në raportin e kontrollit dhe vërtetimit mbi marrjen e sendeve të datës 29.09.2020, vërtetohet se nga ky i akuzuar janë marrë e konfiskuar: 1 pushkë dhjetëshe gjysmë automatike me numër serik 474563; 1 pushkë e gjatë me numër serik 223463; 6 fishekë të pushkës karabinë; 6 fishekë të kalibrit 9x19x7.62; 2 fishekë të kalibrit 9x17 RWS dhe një palë dylbi taktike 52M/100MAT10X.

Po ashtu edhe i akuzuari F.P. është shpallur fajtor për veprën penale sipas këtij aktgjykimi dhe atë për faktin se me provat e administruara, është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Sikurse të akuzuarit tjerë edhe i akuzuari F.P., ka pasur biseda dhe takime të shpeshta me të dyshuarin S.R., e ku të gjitha bisedat i kanë në lidhje me shitblerjen e armëve dhe municioneve, ku në disa biseda edhe përmenden emra të armëve dhe kalibrave. Ku nga këto biseda është vërtetuar se i

akuzuari S.R., ka blerë armë dhe ka dërguar persona në lidhje me blerjen e armëve nga F.P.

I akuzuari K.S., veprimet e tija të cilat lidhen në veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, respektivisht se me cilat veprime ky i akuzuar ka konsumuar elementet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor, i njëjti ka pasur biseda e takime të shpeshta me të akuzuarën I.R., ku të gjitha bisedat i kanë lidhur me shitblerjen e armeve e municioneve, ku në disa biseda edhe përmenden emra të armëve e kalibrave. Po ashtu gjykata për këtë të akuzuar ka gjetur e vërtetuar se ka biznes “shitore ushqimore” në fshatin ... të Komunës së I., në afërsi të lokacionit të të akuzuarës I.R., ku në shumicën e bisedave porosisin armë e municione të ndryshme nga I. R., ku bisedat tek i njëjti lokal dhe tek ky i akuzuar shkojnë persona të ndryshëm të interesuar për blerje të armëve e pastaj i njëjti këto armë i ka marrur nga I.R. dhe i ka shitur.

Nga vërtetimi mbi marrjen e përkohshme të sendeve i datës 29.09.2020, vërtetohet se gjatë kontrollit në shtëpinë e të akuzuarit K.S., janë gjetur dhe sekuestruar 71 fishekë të kalibrave të ndryshëm, e që vërtetojnë veprën penale për të cilën edhe është shpallur fajtor i njëjti dhe se bisedat e zhvilluara me të akuzuarën I. R. e me blerës tjerë, kanë pasur për qëllim mblerjen e armëve.

I akuzuari B.H., po ashtu edhe ky i akuzuar ka pasur biseda e takime të shpeshta me të akuzuarën I.R. e ku të gjitha bisedat i kanë zhvilluar lidhur me shitblerjen e armëve e municioneve, ku në disa biseda edhe përmenden emra të armëve e kalibrave, kjo gjykatë ka vërtetuar se i njëjti ka blerë armë nga I.R. Nga raportet e përgjimeve, kjo gjykatë ka vërtetuar se këta të akuzuar kanë ndërmjetësuar dhe bashkëpunuar me katër të akuzuarit e theksuar në lartë për shitblerje të armëve.

Të akuzuarit: S.A., F.A., S.N., T.K., B.B., H.N., H.A. dhe A.M.

Këta të akuzuar janë gjetur fajtor se nga periudha e panjohur kohore në vazhdimësi e deri më datë 29.09.2020, respektivisht deri me datën 14.04.2021, duke vepruar sipas marrëveshjes paraprake e me qëllim të furnizimit, transportimit, këmbimit, ndërmjetësimit e shitjes së paautorizuar të armëve, kanë transportuar, ndërmjetësuar dhe shitur armë të llojeve të ndryshme në mënyrë të paautorizuar, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore të kundërligjshme.

Këta të akuzuar, gjykata ka vërtetuar se në lidhje me veprën penale për të cilën akuzohen kanë pasur bashkëpunim të ngushtë edhe me të akuzuarit tjerë, kanë pasur takime të shpeshta dhe biseda telefonike në mes vete, ku do të ceket roli dhe veprimi i secilit të akuzuar veç e veç.

I akuzuari B.B.

Gjykata për të akuzuarin B.B., ka gjetur se për të njëjtën janë aplikuar masa të fshehta të hetimit si: vëzhgimi dhe përcjellja e vendndodhjes me anë të GPS e cila ka qenë e vendosur në veturën e tij të tipit “Audi 80” ngjyrë e zezë, i njëjti gjatë aplikimit të masave të fshehta ka pasur lëvizje e që shumica e këtyre lëvizjeve kanë qenë tek i akuzuari S.A., ku herë pas here ka shkuar 2 deri 3 herë mbrenda ditës, po ashtu duke u bazuar në pajisjen “GPS”, i njëjti ka qenë disa herë edhe në P., tek S. K., ku nga e gjithë kjo gjykata ka vërtetuar se të gjitha lëvizjet e këtij të akuzuari kanë qenë me qëllim të shitblerjes së armëve.

Gjykata, po ashtu në bazë të vërtetimit mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të datës 14.04.2021, ka vërtetuar se tek ky i akuzuar janë gjetur dhe sekuestruar: 1 pistoletë “AB884-1974”; 1 telefon “Samsung” i përdorur në kryerjen e veprës penale; 1 pistoletë “Sig Sauer” 7.65 mm; municion 7.65; municion gjuetie 12 mm; municion gjuetie-kalibri i panjohur; municion 9 mm; dy pistoleta me gas; municion 7.62 mm; municion me gas; municion 9 mm si dhe municion 6.35 mm. Nga raporti i kontrollit në shtëpinë e të akuzuarit B.B. me vendbanim në fshatin “...” të Komunës së F., janë gjetur e konfiskuar dëshmitë e të cilat janë fotografuar e evidentuar, në bazë të të cilave fotografi, gjykata ka vërtetuar faktin se në shtëpinë e të njëjtit janë gjetur sasia e armëve dhe municionit të cekura më lartë. Këto armë e municion, janë armë të cilat janë furnizuar me qëllim shitje e blerje, e ku i akuzuari B.B. ka qenë në kontakt me të akuzuarin S.A.

Po ashtu nga raporti i ekzaminimit të pajisjeve elektronike (telefonave) të të akuzuarve i datës 18.01.2022, rezulton që në telefonin e të akuzuarit B.B., në “Samsung Galaxy A10S” e cilësuar si provë D#7, janë gjetur fotografi të armëve (pistoletave) dhe të një pushke gjuetie.

I akuzuari H.A.

Gjykata këtë të akuzuar e ka shpallur fajtor për veprën penale në bashkëkryerje dhe vazhdimësi importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve nga neni 364 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 lidhur me nenin 31 të KPRK, ashtu si është theksuar edhe në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata në bazë të vërtetimit mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të datës 14.04.2021, ka vërtetuar se tek ky i pandehur janë gjetur dhe sekuestruar: 1 telefon

“Samsung A10S”; 1 telefon “Samsung” model i vjetër; 1 Sim-kartelë të “Vala” me numër 044-185-141. Gjitha këto të gjetura në shtëpinë e H.A. Po ashtu janë gjeutur edhe: 1 pushkë gjuetie “Karatay Magnum 15882”, 109 fishekë të kalibrave të ndryshëm; 1 gëzhhojë; pjesë pushke (dorëza dhe 1 bajonetë), 1 pistoletë “Zoraki 917-T” me një karikator të zbrazët 1218-00366; 1 këllëf i pushkës së gjuetisë; gjitha të gjetura në kioskën numër 32 përballë shtëpisë së H.A. Ku nga këto prova shihet se i njëjti armët të cilat i ka blerë e furnizuar me qëllim shitjeje i ka mbajtur në këtë kioskë dhe të njëjtat pastja jashë shitur e blerë.

Po ashtu nga provat e administruara e të siguruara gjatë hetimeve ndaj këtij të akuzuari, gjykata ka vërtetuar se ndaj të njëjtit janë aplikuar masa të fshehta të hetimit, vëzhgim e përcjellje e vendndodhje me anë të “GPS” e cila ka qenë e vendosur në veturën e tij të tipit “Golf ...” ngjyrë e zezë. Gjatë aplikimit të kësaj mase i njëjti ka pasur lëvizje të shumta me veturën e tij, ndër ta ka qenë tek i akuzuari S.A. në fshatin ... të Komunës së L..., po ashtu gjatë zbatimit të këtyre masave edhe i akuzuari S.A., ka qenë disa herë tek shtëpia e H.A. Nga këto masa të fshehta, vërtetohet qartë dhe pamëdyshje se këta të akuzuar janë njohur ndërmjet vete dhe kanë bashkëpunuar në shitjen-blerjen e armëve, e jo si pretendojne këta se nuk janë njohur ndërmjet vete, nuk kanë asnjë ndërlidhje dhe se nuk kanë bashkëpunuar. Pra, provat e administruara, e posaqërishtë masat e fshehta hetimore tregojnë se të njëjtët janë njohur ndërmjet vehte, kanë bashkëpunuar dhe se kanë marrë pjesë së bashku në shitjen-blerjen e armëve.

Lëvizjet e H.A., kryesisht kanë qenë në M. dhe në disa fshatra të P. gjithashtu duke u bazuar në pajisjen “GPS” edhe tek një person tjetër S. V. i cili më parë ka qenë i hetuar për trafikim të armëve, e ku nga të gjitha këto gjykata, pamëdyshje vërtetoi se i akuzuari H.A., është marrë me trafikim të armëve dhe municioneve. Po ashtu e rëndësishme të theksohet është se nga raporti i përgjimit i datës 10.02.2021, gjatë kësaj periudhe kohore, gjykata ka vërtetuar se ky i akuzuar ka qenë i kujdesshëm në biseda telefonike, mirëpo të gjitha këto biseda kanë qenë të drejtuara për shitjen-blerjen e armëve, e ku në shumicën e rasteve vetëm ka lënë takime me persona tjerë për këtë qëllim, si dhe ka përdorur rrjetet sociale për komunikim me qëllim të shitjes-blerjes së armëve.

I akuzuari S.A.

Gjykata, në raport me këtë të akuzuar dhe veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, ka gjetur se gjatë aplikimit të masave të fshehta të hetimit-vëzhgim, i njëjti ka pasur biseda dhe takime me persona të ndryshëm e edhe me të akuzuarit tjerë, po ashtu në bisedat telefonike të tij janë përmendur armë dhe municione. Gjatë aplikimit të masave të përgjimit i njëjti është kontaktuar nga persona të ndryshëm dhe vetëm i kanë

thënë “*a je aty se jemi duke ardh*”, i njëjti i është përgjigjur “*po këtu jam ejani*” të gjitha këto biseda janë bërë në lidhje me shitblerjen e armëve.

Po ashtu nga masat e fshehta të hetimit tek i akuzuari S.A., ka ardhur shumë herë i akuzuari B.B. me veturën e tij dhe gjithashtu disa herë edhe S.N., zakonisht në orët e mbrëmjes ka qenë edhe i akuzuari H.A. e gjithashtu edhe S.A. Ky i akuzuar ka qenë disa herë në V. tek H.A. e të gjitha këto lëvizje janë bërë në lidhje me shitblerje të armëve, si dhe gjykata në bazë të provave ka vërtetuar se i akuzuari S.A. është furnizuar me armë e municione tek të akuzuarit B.B. dhe H.A.

Nga raportet e përgjimeve të datës 28.01.2021, 03.02.2021 dhe 01.03.2021, vërtetohet se i akuzuari përdorë zhargon fjalësh të ndryshme për shitblerjen e armëve apo municionit, personat të cilët shkojnë për të blerë armë apo municion shumicën e rasteve kanë shkuar tek shtëpia apo lokali i S.A., pa paralajmërim vetëm duke i treguar se janë në oborr të shtëpisë ose para lokalit të tij. Të akuzuarin S.A., shpesh herë e ka vizituar i akuzuari B.B. dhe shumica e këtyre takimeve janë bërë pa kontakt telefonik. Ka pasur bashkëbisedues që kanë kërkuar tulla, 2 deri 3 kilogram mjaltë (si zhargon i fjalës armë), telefona etj.

Me datë 10.02.2021 në ora 18:30:27 në këtë bisedë S.A. me numrin e tij të telefonit 045..., bisedon në telefon me një person me emrin H., gjatë kësaj bisede H. i thotë S. “*do shrafa të kerrit po më vyjnë, thash*”, S. i përgjigjet “*ani i gjajna kur dush, hiq mos ta nin, hajde kur dush gjajna*” nga kjo bisedë telefonike, gjykata vërtetoi se kjo bisedë ka të bëjë me shitblerje të municionit (plumbave), por i referohet si “*shrafa*”. Ku marrë në konsideratë edhe bisedat tjera me të akuzuarit e tjerë e të cilët i njeh, e ku ky i akuzuar mohon se i njeh të akuzuarit e tjerë, por në fakt i gjithë komunikimi ka qenë rreth armëve e municionit shi sihtjes e po ashtu edhe blerjes.

Me datë 10.02.2021 në ora 22:59:51 në këtë bisedë S.A. me numrin e tij të telefonit 045..., bisedon në telefon me një person me emrin P., gjatë kësaj bisede P. i thotë S. “*Jam P. i P., thashë të vesë mos ki asi bre rastësisht se ma kanë pru një dorë të myzhdes, thash mos ki të vesë*”, S. i thotë P. “*O P. a e din çka je tu than-folë o ti jaran*”. Nga kjo bisedë gjykata gjithashtu vërtetoi se personi me emrin P. kërkon nga S. furnizimin me municione, për shkak se i njëjti ka një aheng familjar “*dorë të myzhdes*” dhe kërkon municion për ta përdorur për këtë aheng.

Nga këto kontakte të këtij të akuzuari me të akuzuarit e tjerë të këtij rasti (e të theksuar sikurse më lartë), e po ashtu edhe me bisedat telefonike të cilat i ka pasur me të bashkëakuzuarit rreth furnizimit e shitjes së armëve, e bisedat me personat si “P.” e “H.”, vërtetohet se ky i akuzuar, ka pasur bisedat e po ashtu edhe ka bërë shitjen e

armëve e municioneve të cilat i ka furnizuar për vete nga të bashkëakuzuarit e tjerë me të cilët ka kontakte të vazhdueshme e të cilat kontakte janë vërtetuar me masat e fshehta teknike të vëzhgimit e hetimit.

I akuzuari H.N.

Po ashtu edhe për këtë të akuzuar gjatë aplikimit të masave të fshehta të përgjimit dhe vëzhgimit i njëjti ka pasur biseda dhe takime të ndryshme me persona të ndryshëm si dhe me të akuzuarit tjerë, bisedat të cilat i ka zhvilluar i njëjti ka qenë shumë i kujdesshëm por në disa biseda janë përmendur armë dhe municione. Gjykta, bazuar në këto prova të administruara, ka ardhur deri tek konkludimi e nxjerrja e këtij aktgjykimi me të cilin të akuzuarin e ka gjetur fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjykata, ka vërtetuar në bazë të provave të administruara se i akuzuari H.N., ka bashkëpunuar me të akuzuarit e tjerë si S.N. e T.K., ku së bashku të njëjtit disa herë kanë shkuar tek S. K. në P., ku këto takime gjykata i ka vërtetuar përmes fotografive e video, të cilat janë marrë gjatë aplikimit të masave të fshehta, respektivisht këto masa të fshehta vërtetojnë takimet e këtyre të akuzuarve ndërmjet vehte.

I akuzuari H.N. e i akuzuari S.N., me veturën e H.N. të tipit “...” me ngjyrë të bardhë, kanë shkuar deri tek S. K., veturën e kanë parkuar në një distancë më të largët dhe nga aty këmbë kanë shkuar në marketin “Te K.” me pronar S. K., kanë hyrë në market, janë takuar me S. dhe pas diku 15 minutave kanë dalur nga marketi, ku kanë vazhduar rrugën. Të njëjtit janë përcjellur e vëzhguar nga policia dhe janë ndaluar në hyrje të F., ku gjatë kontrollit është gjetur një revole e tipit “Zoraki” e konvertuar me mbishkrim “Sig Sauer” dhe 5 fishekë për të njëjtën.

Gjithashtu, këta të akuzuar kanë pasur biseda e takime edhe me të akuzuarin F.A., ku gjatë një takimi tek shtëpia e F. të akuzuarit H.N. e T.K., gjatë vëzhgimit nga ana e zyrtarëve policor janë dëgjuar krisma të armëve, ku është vërtetuar se të njëjtit kanë përdorur armë tek shtëpia e F.A. në fshatin ... (Zh.) të komunës së Gj.

Se raportet e masave të fshehta teknike të hetimit, respektivisht raportet e përgjimit kanë vërtetuar akuza e ngritura ndaj këtij të akuzuarit, raporti i përgjimeve i datës 25.02.2021 për të akuzuarin H.N., paraqet se gjatë bisedave telefonike me persona të ndryshëm përmend edhe armë edhe çmime të armëve, ku në një përgjim i thotë gruas së tij “*shko në garazhe merri 1.000 Euro edhe jepja*”, po ashtu gjatë përgjimeve i njëjti ka diskutuar me F.A., për ulje të çmimit të armëve për 20 Euro në një armë, ku nga këto përgjime gjykata ka vërtetuar po ashtu se ky i akuzuar ka kryer veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

I akuzuari T.K.

I akuzuari T.K., gjithashtu si edhe të akuzuarit e tjerë është shpallur fajtor për veprën penale sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Se i akuzuari është fajtor për veprën penale për të cilën është akuzuar, gjykata e ka vërtetuar nga zbatimi i masave të fshehta teknike të vëzhgimit e hehtimit, ku ky i akuzuar ka pasur takime të shumta me të akuzuarit H.N. e S.N. Gjithashtu i njëjti së bashku me të akuzuarin H.N. e S.N., kanë qenë disa herë tek personi S. K., e të gjitha këto lëvizje e takime janë bërë për shitblerje të armëve dhe municioneve.

Nga raporti i përgjimeve i datës 01.04.2021 si dhe 21.04.2021, tek i akuzuari T.K., gjatë aplikimit të masave të përgjimeve është vërtetuar se i njëjti ka pasur komunikime me persona të ndryshëm me qëllim të shitblerjes së armëve, mirëpo gjatë komunikimit kanë përdorur zhargone fjalësh të tjera si sinonim për shitblerjen e armëve, po ashtu në shumicën e rasteve vetëm janë takuar por pa biseduar në telefon.

Me datë 30.03.2021 në ora 15:17:54 në këtë bisedë T.K. me numër të telefonit 044..., bisedon në telefon me një person të panjohur me emrin N. i cili përdorë numrin e telefonit 045... Gjatë kësaj bisede T.K. i thotë *“Te poligoni kha naltë dyrt mshelë ishin pse”*, Personi i panjohur N. i përgjigjet T.K., *“jo nuk jam duke punuar, edhe ashtu nuk ka plumba edhe me kan aty plumba (fishek) nuk ka”*, T.K. i thotë *“A ban me gju nja 2-3 copa njani don me provu”*, N. i thotë T.K. *“Po smunesh se veq kamerat i ka aty, vetem nëse don me dal ma poshtë”*. Nga kjo bisedë gjykata vërtetoi se i akuzuari T.K., ka shkuar tek personi N. për të blerë plumba dhe ka kërkuar nga ai që të gjuaj 2-3 herë, i njëjti i ka rekomanduar që të dal më poshtë të gjuaj për shkak të kamerave.

Me datë 01.04.2021 në ora 18:34:19, po ashtu në një bisedë T.K. me numër të telefonit 044..., bisedon në telefon me F. i cili përdor numrin e telefonit 045... Gjatë kësaj bisede T.K. i thotë F. *“hajtë bami gati nja 20 copa se nuk po kryhet, e une po vi mi marr e duhet me ja qu”*, F. i thotë *“Hajde te shpija se nuk muj me dalë”*, ku nga kjo bisedë po ashtu gjykata vërtetoi se i akuzuari T.K. i thotë personit me emrin F. t’ia bëjë gati 20 copa (plumba) me qëllim që t’ia dërgojë dikujt tjetër për shitblerje.

Gjykata, nga takimet të cilat ky i akuzuar i ka pasur me të akuzuarit e tjerë të çështjes, të provuarit e armëve, gjuajtja me to për t’i provuar për t’i blerë armët e municionet dhe shitja e blerja tek personat të tjerë si personi me emrin N. e personi me emrin F., vërteton e se ky i akuzuar jo vetëm se ka bashkëpunuar me të akuzuarit

e tjerë, por edhe ka bërë shitjen e blerjen e armëve me të bashkëakuzuarit e tjerë e me persona tjerë të paidentifikuar, apo të identifikuar vetëm si emra e pseudonime.

Të akuzuarit: S.N., F.A. dhe A.M.

Gjykata të akuzuarin S.N., po ashtu e ka gjetur fajtor. Gjykata e ka gjetur fajtor me rastin e nxjerrjes së këtij aktgjykimi për veprën penale sikurse theksuar në këtë aktgjykim. Me aplikimin e masave të fshehta të hetimit për këtë të akuzuar, ku ky i akuzuar ka pasur biseda me persona të ndryshëm për shitblerje të armëve, po ashtu shumicën e bisedave dhe takimeve i ka pasur me të akuzuarit H.N., T.K. dhe F.A.

Nga raporti i përgjimeve i datës 25.02.2021, kjo gjykatë ka gjetur se bisedat e zhvilluara në mes të akuzuarit S.N. dhe bashkëbiseduesve, ky i akuzuar është marrë me veprimtarinë e shitblerjes së armëve, por i njëjti ka qenë i kujdesshëm gjatë bisedave telefonike, ku ka përdorur zhargone të ndryshme për zëvendësimin e fjalëve armë dhe municione, takimet e tij me bashkëbiseduesit i ka bërë në shtëpinë e tij.

I akuzuari F.A., po ashtu gjatë aplikimit të masave të fshehta i njëjti ka pasur biseda e takime të shumta me të akuzuarit H.N. e S.N. e të gjitha këto takime dhe lëvizje janë bërë për shitblerje të armëve e municioneve, si dhe gjatë administrimit të provave gjykata ka vërtetuar se H.N. e S.N., kanë qenë tek shtëpia e të njëjtit në lidhje me blerjen e armëve, ku është vërtetuar se në oborrin e tij edhe i kanë provuar armët a janë funksionale duke gjuajtur me to.

Nga raporti i përgjimeve i datës 01.04.2021, shihet se i akuzuari F.A., me datë 15.03.2021 në ora 14:33:11 me numër të telefonit 043..., bisedon në telefon me një person me emrin B. i cili përdor numrin e telefonit 044... Gjatë kësaj bisede B. i thotë F. *“A pe din me kanë po fole”*, F. i thotë B. *“Jo valla nuk pe di”*, B. i thotë F. *“Unë jamë prej V., B. T., për atë piunin, ngo B. knenaj une kur flas nuk i bi pishman çka të foli ashtu jetë, unë të kam than deri me 15 edhe pse unë kam pas myshteri edhe qaj mka thirr po unë i kam than se deri me 15 është e shit, prej 15 nuk është e shitë, deri me 15 me mi dhanë sa dush e kush me ka pytë e kush e ka qyr unë i kam than mas datës 15 mujna me ba Pazar”*, F. i thotë B. *“Nëse munesh me shit t’i shite”*, B. i thotë F. *“Nëse t’i e din që je mishteri edhe që e merr unë ty ta la nestra masneser so problem kur tem thuash”*. Nga këto komunikime e po ashtu edhe ndërlidhja e këtij të akuzuari edhe me të akuzuarit e tjerë, përdorimi (provimi-testimi) i armëve, mbajtja e fotove në pajisje telefonike, e aq më shumë komunikimi për shitje e blerje të armëve e municioneve, vërteton faktin se ky i akuzuar me të akuzuari e tjerë kanë bashkëpunuar në shitblerjen e armëve.

I akuzuari A.M., gjithashtu i njëjti ka pasur takime dhe biseda me të akuzuarit e lartëcekur për shitblerje të armëve. Ndër bisedat që i ka pasur kanë qenë me të akuzuarin T.K., ku T.K. i thotë *“Për qata sa po ma jep me ardh me marrë, a mi hjek bile nja 20 euro”*, A. i thotë *“Ja valla nër qato qaq vetë e kam marrë, se qar pare e kam marrë vet”*, nga kjo bisedë shihet se i akuzuari ka biseduar për shitblerje të armëve. Ku përpos që është furnizuar me armë edhe ka bërë shitjen e armëve, ndërsa në anën tjetër i akuzuari A.M., ka blerë armë nga i akuzuari T.K., e që e dëshmon edhe kontakti e biseda telefonike.

Me datë 21.03.2021 në ora 19:41:53 në këtë bisedë T.K. me numër të telefonit 044... bisedon në telefon me A. i cili përdorë numrin e telefonit 044... Gjatë kësaj bisede T.K. i thotë A. *“Hej me dalë e me marrë qat metër dru sap o ma jepë, se e kam për veti”*, A. i thotë T. *“Jo valla ner qato nuk muj me ta dhanë, se unë qaqë e kamë me hupë unë nuk mujë”*. Në këtë bisedë po ashtu gjykata vërtetoi se bisedohet për shitblerje të armëve por vetëm duke përdorur zhargon fjalësh.

Me datë 23.03.2021 në ora 17:47:22, në këtë bisedë T.K. me numër të telefonit 044..., bisedon në telefon me A. i cili përdor numrin e telefonit 044... Gjatë kësaj bisede T.K. i thotë A. *“Për qata qka bane se me thirri ai djali veti tha qka po ban a po a jo, dhe sa ja kishe dhan me qef kallxom ti kallxom, me qef ti”*, A. i thotë T. *“vallahi shumë pare, po se fundi po vi edhe e kqyrim”*, T.K. i thotë A. *“Hajde edhe ky te shpija ishë kqyre ti ata, tani natana so problem une vi, hajde bajna muhabet kqyre me qef sapo mun me ja dhanë, e ka pa ata ski qka”*.

Me datë 23.03.2021 në ora 18:36:45 në këtë bisedë T.K. me numër të telefonit 044..., bisedon në telefon me A. i cili përdor numrin e telefonit 044... Gjatë kësaj bisede T.K. i thotë A. *“a je ardhë”*, A. i përgjigjet T. *“Erdha hajde dil jashtë”*. Gjatë këtyre bisedave të njëjtit bisedojnë për shitblerje të armëve, por tregohen të kujdesshëm duke mos përmendur emra të armëve.

Gjykata, nga komunikimet në telefon, shihet se këta të akuzuar kanë pasur bashkëpunim ndërmjet vete lidhur me shitjen e blerjen e armëve, ku kanë përdorur shprehje të ndryshme në komunikimet e tyre si sinonime e kamuflime të bisedave lidhur me shitblerjen e armëve. Gjykata, alibit (deklarimet mbrotjëse të të akuzuarve) sikurse dhënë si në stadin e hetimeve e po ashtu edhe në stadin e shqyrtimit gjqësor, nuk i ka konsideruar si të bazuara, sepse të gjitha këto komunikime janë komunikime të cilat ndërlidhen me shitblerjen e armëve e jo me çështje tjera të cilat pretendojnë të akuzuarit.

I akuzuari S.K.

Gjykata këtë të akuzuar e ka shpallur fajtor për veprën penale mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK, për shkak se prej datës së pa vërtetuar e deri me datën 14.04.2021, duke vepruar në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm, ka mbajtur armë pa autorizim ashtu që gjatë kontrollit nga ana e policisë në shtëpinë e tij në P., janë gjetur e sekuestruar një pushkë gjuetie dy tytëshe me numër serik 01S8874 dhe 7 fishekë të kalibrit 12 mm.

Gjykata, se e ka vërtetuar këtë fakt se i akuzuari ka mbajtur nën kontroll e posedim armën në fjalë, e dëshmon edhe vërtetimi mbi marrjen e përkoshme të sendeve, ku nga i kauzuar është konfiskuar një armë gjuetie “Huglu” e prodhimit turk me numër serik 01S8874 e kalibrit 12mm, e cila armë është mbajtur pa leje të organit kompetent.

Pra nuk ekziston si i qenë pretendimi i të akuzuarit e mbrojtjes së tij se arma nuk është e tij, por e prindit të tij të ndjerë, gjykata ka vërtetuar se me rastin e kontrollit kjo armë është gjetur në shtëpinë e të akuzuarit dhe e njëjta është sekuestruar nga i kauzuarit. Këto fakte tregojnë qartë se i akuzuari ka pasur në posedim këtë armë, e ka ditur se e ka në posedim pa leje e autorizim të organit kompetent dhe se me rastin e kontrollit tek ai është gjetur. Pretendimi i mbrojtjes e të akuzuarit, po të ishte edhe i mirëqenë se kjo armë ka qenë e babait të tij të ndjerë, por me rastin e kontrollit tek ky i akuzuar është gjetur kjo armë dhe atë në shtëpinë e tij, ku i njëjti e ka ditur se e posedon këtë armë, se kjo armë nuk është mbajtur nga i akuzuari me autorizim e lejene e organeve kompetente, por të njëjtën e ka mbajtur pa leje e autorizim dhe atë duke e ditur se është duke e mbajtur.

Gjykata, gjithashtu në drejtim të të gjithë të akuzuarve të cilëve gjatë kontrollit të shtëpive të tyre janë gjetur armë, municione e pjesë të armëve, është vërtetuar se këto armë kanë qenë pa lejen e organeve gjegjëse dhe se kemi të bëjmë me armë të llojit e tipit sikurse të theksuara në këtë aktgjykim. Armët, llojin e tyre, kalibrat si dhe të gjitha përshkrimet teknike të tyre, gjykata e ka vërtetuar nga raportet e ekzaminimit të armëve (armëve, municionit e pjesëve të armëve) dhe atë raportet e datave 21.01.2021 e 28.04.2021, ekzaminime të bëra nga Njësia Ekspertimit të Armëve të Zjarrit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë. Ku të gjitha këto armë të gjetura tek të akuzuarit, por edhe armë tjera të përmendura gjatë komunikimeve të tyre e në pajisjet elektronike të ekzaminuara, janë prova të cilat dëshmojnë se këto armë fillimisht janë transportuar e furnizuar e pastaj ato janë shitur e blerë ndërmjet të akuzuarve me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror. Pjesa më e madhe e armëve është furnizuar nga të akuzuarit S. e I. R. (pjesa më e madhe e armëve, por edhe nga persona tjerë) e më pastaj nga të akuzuarit e tjerë janë blerë nga këta të akuzuar apo kanë ndërmjetësuar në shitjen dhe blerjen e tyre.

Mbrojtja e të akuzuarve dhe gjetjet e gjykatës:

Gjykata, mbrojtjen e të akuzuarve, nuk e ka konsideruar si relevante dhe që e paraqet të vërtetën faktike, pasi që ekziston një sërë provash të cilat vërtetojnë se të akuzuarit, janë përgjegjës për veprat penale për të cilat janë shpallur fajtor.

Ekzistojnë një sërë provash të cilat e vërtetojnë të kundërtën e mbrojtjes së këtyre të akuzuarve, prova të cilat vërtetojnë faktet se:

- Të akuzuarit nga periudha e panjohur e në vazhdimësi deri me datën 29.09.2020, respektivisht deri me datën 14.04.2021, sipas marrëveshjes e bashkëpunimit, kanë transportuar, ndërmjetësuar dhe shitur armë të llojeve të ndryshme në mënyrë të paautorizuar;
- Të gjitha këto armë të gjetura tek të akuzuarit, por edhe armë tjera të përmendura gjatë komunikimeve të tyre e në pajisjet elektronike të ekzaminuara, janë prova të cilat dëshmojnë se këto armë fillimisht janë transportuar e furnizuar e pastaj ato janë shitur e blerë ndërmjet të akuzuarve me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror. Pjesa më e madhe e armëve është furnizuar nga të akuzuarit S. e I. R. (pjesa më e madhe e armëve, por edhe nga persona tjerë) e më pastaj nga të akuzuarit e tjerë janë blerë nga këta të akuzuar apo kanë ndërmjetësuar në shitjen dhe blerjen e tyre;
- Vërtetimet mbi marrjen e sendeve të datës 29.09.2020 e 14.04.2021, me të cilat vërtetime janë marrë armët, municioni e pjesët e armëve tek të akuzuarit, armë, municione e pjesë të armëve, të theksuara sikurse në këtë aktgjykim në pjesën e konfiskimit të tyre, por edhe me rastin e pjesës së arsyetimit të aktgjykimit, ku është potencuar decitivisht se tek i cili akuzuar, çfarë është gjetur;
- Fotografitë dhe SMS të marra nga pajisjet e të akuzuarve, pra të marrura nga telefonët e të akuzuarve, ku nga këto foto e SMS, vërtetohet qartë se kemi të bëjmë me komunikime të të akuzuarve ndërmjet vehte për shitblerje të armëve e municioneve, e po ashtu edhe nga fotot, ku shihet qartë se në komunikimet e tyre kanë shkëmbyer fotografi të armëve, apo kanë fotografuar armë me qëllim të prezantimit të tyre tek njëri tjetri e me qëllim të shitjes e blerjes së armëve, municioneve e pjesëve të armëve;
- Raportet e përgjimeve dhe të bisedave telefonike duke përfshirë SMS, ku nga këto përgjime shihet qartë se të akuzuarit kanë pasur ndërmjet vete biseda për sigurimin

e armëve e municioneve, e ku këto më pastaj i kanë shitur ndërmejt vehte apo edhe personave të tjerë të tretë sikurse janë të përmendur në këtë aktgjykim, sikurse personit me emrin R., A., N., B. etj.;

- Raportet e vëzhgimit, tregojnë çartë kontaktet dhe takimet e të akuzuarve ndërmjet vehte me qëllim të shitblerjes së armëve e municioneve, po ashtu edhe takimet e njëri tjetrit në shtëpitë e lokalet e njëri tjetrit, ku në disa nga vëzhgimet e bëra nga njësia e vëzhgimit, konstatohet qartë kontakti ndërmjet tyre, e po ashtu edhe përdorimi i armëve me qëllim të testimit të të njëjtave para shitjes e blerjes;
- Raportet e ekzaminimit të armëve të datës 21.01.2021 dhe 28.04.2021, është vërtetuar çartë se këto armë janë armë të ndaluara me ligj, të gjetura tek të akuzuarit dhe se të njëjtat kanë qenë nën posedimin paautorizim e leje të organit kompetent, pra këto armë nga ky ekzaminim është vërtetuar se janë armë të llojit të caktuar, kalibrit të caktuar e të përshkruara sikurse në këtë aktgjykim, për të cilat kërkohet leje e organit kompetent si për t'i poseduar, transportuar e shitur;
- Raporti i ekzaminimit të parave i datës 14.01.2022, me të cilin raport gjykata pa mëdyshje ka vërtetuar se parat e gjetura në posedim të të akuzuarës Ifeta Ramiq, janë para të falsifikuara, e për të cilat para të falsifikuara dhe posedimin e tyre, gjykata të akuzuarën e ka gjetur fajtor për veprën penale të falsifikimit të parasë. Gjykata për këtë fakt nuk e konsideron si të qenë mbrojtjen e të akuzuarës lidur me këtë vepër penale, pasi që faktet, provat dhe rrethanat e provuara në këtë çështje penale, kosistojnë me veprën e përfunduar nga e akuzuara, respektivisht veprën e falsifikimit të parasë;
- Raportet e ekzaminimit të telefonave të datës 13.12.2021 e 18.01.2022, si dhe fotodokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës, dëshmojnë komunikimin, bashkëpunimin dhe bashkëveprimin e të akuzuarve në drejtim të kryerjes së veprës penale. Nga këto prova gjykata ka gjetur se ka pasur komunikime ndërmjet të akuzuarve, ka pasur shkëmbim të fotografive të armëve të cilat janë pjesë e veprës penale, komunikime për blerje e shitje të armëve dhe po ashtu përdorim i armëve (testim i tyre) me qëllim të shitjes apo para shitjes e blerjes së tyre. Ku nga këto prova, vërtetohet e kundërta e asaj çfarë të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre, kanë pretenduar me rastin e dhënies së pretendimeve mbrojtëse e fjalës përfundimtare. Nga këto prova të rezultuara nga ekzaminimi i telefonave dhe fotodokumentacioni lidhur me çështjen, shihet qartë se pretendimet mbrojtëse nuk janë të qëna, pasi që nga këto prova vërtetohet çdo element i veprës-veprave penale për të cilën-cilat janë dënuar të akuzuarit.

Përfundimisht, gjykata konsideron se nga provat e administruara në këtë çështje penale, faktet e shtjelluara e të vërtetuara, kanë rezultuar me këtë aktgjykimi, respektivisht me gjetjen fajtor të akuzuarve për veprat penale për të cilat janë shpallur fajtor dhe se mbrojtja e tyre nuk përkon me realitetin, apo të gjeturat në këtë çështje penale, e që gjykata përfundimisht i ka gjetur fajtor.

Vendimi mbi dënimin:

Gjykata, gjatë vendosjes për dënimin nuk gjeti ndonjë rrethanë tejet lehtësuese e cila do të ndikonte në caktimin e llojit dhe nivelin e sanksionit penal, por si rrethana ndaj të akuzuarve mori:

- **Gjendjen materiale** e të akuzuarve, ku gjendja e tyre materiale është nën mesataren familjare, ku shumica prej këtyre të akuzuarve janë të pa punë, ndërsa një pjesë e tyre janë bujq si dhe disa si punëtorë të thjeshtë, ku kjo e bënë gjendjen e tyre e të familjes jo të qëndrueshme financiarisht e materialisht;
- **Faktin se të gjithë të akuzuarit janë mbajtës të vetëm të familjes**, ku përpos që janë mbajtës të vetëm të familjes së tyre, disa prej tyre në përbërjen familjare janë bartës-përkujdesen materialisht edhe për fëmijët e tyre të moshës së re të cilët nuk kanë mundësi të kujdesen për vete;
- **Të dënuar më herët për vepra penale**, janë të akuzuarit S.N., B.B. e H.N. të gjykuar edhe më parë për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve. Po ashtu për të akuzuarin B.B. zhvillohet edhe një procedurë tjetër për vepra penale tjetër, por gjykata nuk e ka konsideruar si rrethanë rënduese për faktin se kjo çështje penale nuk është përfunduar me vendim të formës përfundimtare. Por, historiku kriminal i të akuzuarve të cilët vetëm se janë të dënuar për vepra penale të cilat kanë të bëjnë me armët dhe se përveç që janë dënuar për vepra penale, janë të dënuar për vepra të njëjta penale, e që nënkupton me recidivizëm;
- **Sjellja e tyre gjatë gjykimit**, ku të akuzuarit kanë pasur sjellje korrekte gjatë gjykimit, ku sjellja e tyre ka qenë korrekte ndaj gjykatës dhe palëve në proces gjyqësor, duke respektuar edhe rendin e procedurën në gjykatore. Gjykata këtë fakt e ka konsideruar si rrethanë me rastin e vendosjes së llojit të sanksionit penal dhe nivelit të tij, e më konkretisht në benefit të të pandehurve për ta përcaktuar saksionin penal dhe nivelin e tij;

- **Involvimi dhe roli në kryerjen e veprës penale**, ku të akuzuarit, gjykata i ka dënuar me dënimin me burgim dhe me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke marrë në konsideratë rolin e tyre në kryerjen e veprës penale. Gjykata po ashtu të akuzuarën I.R. e ka gjetur dhe shpallur fajtor edhe për veprën penale falsifikim i parasë pasi që gjatë kontrollit në shtëpinë e saj është gjetur dhe konfiskuar një kartmonedhë prej 100 (njëqind) Euro, e cila pas ekzaminimit ka rezultuar të jetë totalisht e falsifikuar. Gjykata gjithashtu edhe të akuzuarin S.K., e ka gjetur fajtor për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, tek i cili gjatë kontrollit nga ana e policisë në shtëpinë e tij është gjetur dhe konfiskuar një pushkë gjuetie dy tytëshe si dhe 7 fishekë të kalibrit 12 mm. Ku ky i akuzuar është gjetur fajtor vetëm për veprën penale të mbajtjes në kontorll e posedim të armës, në krahasim me të akuzuarit tjerë që përpos që i kan mbajtur këto armë, i kanë trnasportuar të njëjtat, janë furnizuar dhe i kanë shitur këto armë ndërmejt vehte e po ashtu edhe personave tjerë;

Gjykata, me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin, si rrethana rënduese e tejet rënduese ka konsideruar:

- **Kryerjen e veprës penale si bashkëkryerje (të organizuar) dhe mjetet-armët e rrezikshme që janë mbajtur në posedim**, ku vepra penale nga të akuzuarit është kryer në bashkëkryerje dhe atë nga një numër i madh i të akuzuarve të cilët kanë bashkëvepruar, bashkëpunuar në shitjen e armëve, municionit dhe pjesëve të armëve. Armët të cilat janë shitur, janë mjete të rrezikshme për rrethin shoqëror dhe janë armë jo vetëm të gjahut, por edhe armë luftarake si AK-47 etj. Këto armë janë furnizuar, shitur e blerë sipas marrëveshjeve dhe i janë dhënë personave të ndryshëm në blerje e që paraqet rrezik potencial, rrezikshmëri potenciale e sepse janë mjete të rrezikshme për jetë e sidmos kur merret në konsideratë se disa nga këto janë armë luftarake. Se me këtë veprimtari kriminale janë marrë të akuzuarit në bashkëkryerje dhe për një kohë të gjatë, tregon edhe fakti se të njëjtët janë marrë me këtë veprimtari jo vetëm për t'i poseduar këto armë, por edhe për t'i shitur e blerë, e transportuar edhe pse janë shumë të rrezikshme. Pra, këtë transport, posedim, shitje të armëve e kanë bërë për përfitim material, por pa marrë në konsideratë rrezikshmërinë shoqërore të këtyre armëve e rrezikun e përdorimit të tyre, e që paraqet edhe rrethanë rënduese për të akuzuarit sepse këtë veprimtari kriminale e kanë ushtruar për një kohë të gjatë dhe atë me një sasi të konsiderueshme të armatimit;
- **Rrezikshmëria-vlera e mbrojtur shoqërore**, vepra penale e importit, eksportit, furnizimit, transportimit, prodhimit, këmbimit, ndërmjetësimit ose shitjes së paautorizuar të armëve, në rastin konkret kjo vepër është kryer përmes (me shitjen)

e mjeteve (armëve) të rrezikshme, duke shitur e blerë armë të llojit luftarak ndërmjet tyre, ku po të shikohen figurativisht veprimet e të akuzuarve, do të shikohet se kanë të bëjnë me armë, por nëse shikohen raportet e kzinimit të këtyre armëve në mesin e tyre ka armë luftarake, armë të rrezikshme që paraqesin rrezikshmëri për shoqërinë dhe sigurinë;

- **Shkallën e përgjegjësisë penale**, ku varësisht pjesëmarrjes dhe rolit të të akuzuarve në kryerjen e veprës penale, gjykata për disa nga të akuzuarit bazuar në këtë rrethanë ka shqiptuar dënim më të ashpër e për disa të akuzuar dënim më të butë, por gjithsesi duke marrë në konsideratë historikun kriminal të mëparshëm të të akuzuarve dhe shkallën e involvimit, pjesëmarrjes në kryerjen e veprës penale, ku disa nga të akuzuarit kanë pasur rolin e furnizimit e gjetjes së armëve, disa i kanë shitur disa armë, e disa nga ta jo vetëm se i kanë shitur disa armë, por edhe iu është gjetur gjatë kontrollit sasi e armëve të cilat paraqesin rrethanë rënduese në matjen e dënimit, pasi që kanë pasur rol kyç në furnizim, blerje, shitje e ofrimin të armëve e municionit për blerje e shitje;
- **Motivi i kryerjes së veprës penale**, motivi i kryerjes së veprës penale ka qenë motivi financiar. Të akuzuarit për motive të tyre financiare, respektivisht për përfitim material kanë transportuar, ndërmjetësuar dhe shitur armë të llojeve të ndryshme në mënyrë të paautorizuar edhe pse këto armë paraqesin rrezik serioz për shoqërinë, por motivi i tyre ka qenë që të përfitojnë materialisht nga kjo veprimtari dhe atë pa konsideruar asnjëherë interesin e përgjithshëm, por interesin material të tyre, ku këtë veprimtari e kanë ushtruar për një kohë të gjatë për interesa materiale.

Andaj, gjykata në bazë të rrethanave të lartë-theksuara, të akuzuarve iu shqiptoi dënimet sikurse u theksua në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke ardhur në përfundim se edhe me këto dënime të shqiptuara ndaj tyre do të arrihet efekti preventiv i dënimit, respektivisht që në të ardhmen të përmbahen nga këto veprime-kryerja e veprës-veprave penale të këtilla, apo edhe veprave tjera penale.

Vendimi mbi konfiskimin:

Gjykata me këtë aktgjykim ka bërë edhe konfiskimin e mjeteve-pasurisë të cilat rezultojnë nga vepra-veprat penale, por edhe të përdorura në kryerjen e veprave penale, ku: veturën “VW ...” me targa ... e cila është pronë e të akuzuarit B.M.; veturën “VW ...” me targa ... e cila është pronë e S. e I.R. dhe paratë në shumë prej 2.000 (dymijë) Euro nga F.P., të cilat janë mjete-pronë me të cialt është kryer vepra penale (veprat penale) dhe që kanë rezultuar nga vepra penale (veprat penale). Automjetet e lartë-

theksuara e të konfiskuara, janë konfiskuar për faktin se të njëjtat janë përdorur në transportimin, shitjen e blerjen e armëve e municioneve, ku të akuzuarit këto automjete i kanë shfrytëzuar për kryerjen e veprës-veprave penale. Ndrësa sa i përket mejteve financiare, shumës prej 2.000 (dymijë) Euro, gjykata i ka konfiskuar nga i akuzuari për shkak se ka gjetur se kjo shumë e parash rezulton nga vepra penale, pasi që F.P., nuk ka prezantuar asnjë dëshmi që të vërtetoj se këto mjete financiare janë të krijuara nga ndonjë veprimtari e ligjshme, e jo si rezultat i kësaj vepre penale, ku i akuzuari F.P., në bashkëkryerje edhe me të akuzuarit tjerë S.R. (e të tjerë), ka bërë shitje të armëve e nga të cilat shitje të armëve ka rezultuar edhe me këto mjete financiare të konfiskuara.

Armët, municioni, pjesët e armëve dhe kartëmonedha prej 100 (njëqind) Euro, të konfiskuara me këtë aktgjykim, janë mejte me të cilat është kryer vepra penale, respektivisht janë armë e municione e pjesë të armëve të cilat janë shitur apo mbajtur me qëllim shitjeje, e të cilat janë jashtë qarkullimit dhe se të mbajtura nga të akuzuarit pa lejen e autorizimin e organit kompetent. Ndërsa kartëmonedha prej 100 (njëqind) Euro, është mjet me të cilin është kryer vepra penale, respektivisht është kartmonedhë e falsifikuar dhe e konstatuar nga kezhiminimi forenzik e të cilën e ka mbajtur në posedim e akuzuara I.R., e cila edhe është shpallur fajtores për këtë vepër penale.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale dhe llogaritjen e kohës së paraburgimit:

Vendimi mbi shpenzimet procedurale (paushallin gjyqësor), është marrë në harmoni me nenin 449, 450 e 452 të KPPRK, pasi që gjykata në këtë çështje penale ka marrë aktgjykim dënues.

Vendimi mbi kompensimin e viktimave të krimit, gjykata e mori në harmoni me Ligjin për kompensimin e viktimave të krimit (Ligji Nr.08/L-109).

Vendimi për llogaritjen e kohës së kaluar në masën e paraburgimit në dënimin me burgim është marrë në harmoni me nenin 79 paragrafi 1 të KPRK.

Vendimi mbi konfiskimin është marrë në harmoni me nenin 92 e 366 paragrafi 3 të KPRK, si dhe nenin 276 të KPPRK.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në hamoni me nenin 364 të KPPRK.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI SPECIAL
PS.nr.2/2022 datë 26.07.2023**

**Bashkëpunëtoe Profesionale
Ardita Azemi**

**Kryetari Trupit Gjykses,
Valon Kurtaj**

UDHËZIM JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi në Gjykatën Apelit-Departamenti Special në Prishtinë, përmes Gjykatës Themelore-Departamenti Special në Prishtinë.
